

**Dhuna kundër grave në
partitë politike në
Republikën e
Maqedonisë së Veriut
- Analizë e vlerësimit -**



Dhuna kundër grave në partitë politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- Analizë e vlerësimit -

Shkup, shtator 2020



Ky raport është përgatitur nga Instituti i Ohrit dhe Françeska Binda, Kryetare e Binda Consulting International dhe Instituti Nacional Demokratik me mbështetjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë botim raportit nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	5
Metodologjia.....	6
Sondazhet.....	7
Intervista të thelluara	8
Fokus grupet.....	9
Konteksti: Përfaqësimi politik i grave në Maqedoninë e Veriut.....	10
Konteksti: Pjesëmarrja e grave në partitë politike në Maqedoninë e Veriut	10
Gjetjet e vlerësimit: Dokumente relevante partiake:.....	12
Statutet partiake.....	12
Kodet e Sjelljes	14
Gjetjet e vlerësimit: Pengesat për pjesëmarrjen e grave në parti	15
Gjetjet e vlerësimit: Dhuna ndaj grave në partitë politike	19
Ndikimi dhe raportimi i dhunës ndaj grave në partitë politike.....	23
Përgjegjësia për parandalimin e dhunës ndaj grave.....	29
Përfundim & rekomandime	32
Rekomandime	32

Përmbledhje ekzekutive

Globalisht, më shumë gra se kurdo më parë po marrin pjesë në politikë. Sidoqoftë, me rritjen e angazhimit politik të grave, është shfaqur një shkallë e rritur dhe e shpeshtë e përgjigjeve të dhunshme që i parandalojnë gratë të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u marrë me politikë dhe jetën publike plotësisht dhe në mënyrë të barabartë. Kryerja e një vlerësimi të dhunës ndaj grave (DhKG) në partitë politike është thelbësore për të kuptuar se si ndikon ajo në pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe cilat masa janë të nevojshme për të luftuar dhe eliminuar dhunën.

Ky hulumtim tregon se përfaqësimi i femrave në partitë politike në Maqedoninë e Veriut ka shumë hapësirë për përmirësim. Kur shoqërohet me nën-përfaqësimin e grave në funksionet shtetërore, problemi duket më pak se inkurajues. Sistemi i kuotave i miratuar për përfaqësimin e grave në parlament dhe këshillat lokale vetëm prekë sipërfaqen. Mbështetja deklarative nuk i jep efektet e dëshiruara. Kur bëhet fjalë për zbatimin, lind pyetja nëse partitë politike e njohin rëndësinë dhe ndikimin e rritur të përfaqësimit të grave në parti, institucionet dhe në shoqëri. Derisa të gjithë bien dakord që nën-përfaqësimi dhe dhuna ndaj grave politike ekzistojnë dhe janë mjaft të përhapura madje edhe në komunitetet e avancuara demokratike, jo të gjithë janë të gatshëm të pranojnë këtë formë të dhunës ose që ndryshimi duhet të vijë nga brenda partitë politike.

Partive politike në Maqedoninë e Veriut ju mungojnë mbrojtje themelore për gratë anëtare, aktivistet dhe përfaqësueset politike. Statutet ose kodet e sjelljes së partive heshtin mbi dhunën me bazë gjinore, përfshirë këtu ngacmimet, detyrimet, shpifjet dhe dhunën fizike ose psikologjike. Zyrtarët e partisë - femra dhe meshkuj - pranojnë se nuk e njohin sjelljen e papranueshme si dhunë ndaj grave, por përkundrazi tolerojnë sjelljen e dhunshme si "koston" e përfshirjes në politikë.

Praktika e shpaktimit të nocionit të dhunës gjatë diskutimeve në fokus grupe ishte me vlera të mëdha arsimore dhe transformuese. Në mënyrë të prekshme inkurajoi më shumë të anketuar për të ndarë përvojat e tyre direkte ose indirekte me dhunën si anëtarë të partive politike. Në të njëjtën kohë, gjithashtu ishte treguese për disa përfundime të rëndësishme që:

- disa forma të caktuara të dhunës janë të vështira për t'u identifikuar, veçanërisht në rastet kur nuk ka shenja tradicionalisht të njohura të abuzimit;
- vetëdija e kufizuar për vargun e gjerë të akteve që përbëjnë dhunë mund të ketë implikime të drejtpërdrejta për rezultate të tilla si raportimi;
- vetëdija e vogël për format e fshehta të dhunës mund të normalizojë shfaqjen e tyre dhe të banalizojë madhësinë e pasojave psikologjike për viktimën.

Së fundi, gratë e partive politike që morën pjesë në këtë hulumtim shprehën një gatishmëri, pavarësisht nga përkatësia partiake, për të parandaluar, edukuar dhe mbrojtur gratë.

Hyrje

Kombet e Bashkuara (KB) përkufizojnë dhunën ndaj grave (DhKG) si 'çdo akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton ose ndodhë të rezultojë në dëm fizik, seksual ose psikologjik ose vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënimet e veprimeve të tilla, detyrim ose privim arbitrar të lirisë, qoftë kjo që ndodh në jetën publike ose në jetën private. 'Ky përkufizim kundërshton keqkuptimet e zakonshme ose të rëndomta se dhuna ndaj grave është rreptësisht "dhunë" fizike ose seksuale ose e kufizuar në shtëpi si çështje private. Në të gjithë botën, dialogu dhe veprimet për të adresuar DhKG janë rritur ndjeshëm. Sidoqoftë, tema shpesh është tabu dhe keqkuptohet në shoqëritë ku kulturat konservatore dhe patriarkale vazhdojnë të përcaktojnë rolet të bazë gjinore.

Ekziston gjithashtu një rritje e vetëdijes ndërkombëtare për aktet e dhunës dhe ngacmimeve ndaj grave në politikë, duke njohur konvergjencën e dhunës dhe pjesëmarrjen e grave në publik dhe se si DhKG ndikon në proceset demokratike. DhKG në politikë është një akt i dhunës me bazë gjinore që u drejtohet grave sepse ato përfshihen në veprime politike, të tilla siç është kandidimi i tyre për poste të zgjedhura, pjesëmarrja në parti politike, puna si zyrtarë administrativ në zgjedhje ose pjesëmarrje në ngjarje të fushatës zgjedhore. DhKG në politikë përfshin akte detyrimi ose përdorimi të forcës ose kërcënimeve për të ndikuar në pjesëmarrjen e individëve, gjë që ka ndikim të konsiderueshëm mbi gratë për shkak të statusit të tyre të marginalizuar dhe të cenueshëm në komunitetet e tyre.

Duke pasur parasysh mungesën e informacionit dhe kërkimit mbi DhKG në politikë, Instituti Nacional Demokratik i ka dhënë përparësi hulumtimit, dialogut dhe veprimit për të eliminuar DhKG kundër grave në politikë.

Në vitin 2016, NDI nisi fushatën #NotTheCost (fushata për ndalimin e dhunës ndaj grave në politikë) - një thirrje globale për të vepruar dhe për të rritur ndërgjegjësimin për të ndaluar dhunën ndaj grave në politikë. Titulli i fushatës pasqyron faktin se shumë grave u thuhet se ngacmimi, kërcënimet, abuzimi psikologjik (personalisht dhe në internet), sulmi fizik dhe seksual janë “çmimi i angazhimit në politikë”. Vitet e fundit, NDI ka punuar për të sfiduar këtë pretendim duke rritur ndërgjegjësimin për dhunën me të cilën përballen gratë politikisht aktive, duke mbledhur të dhëna për të, dhe duke ngritur kapacitetet midis partnerëve tanë për të zbutur ndikimin e saj dhe për ti marrë në përgjegjësi autorët e krimeve.

Ky raport është rezultat i hulumtimit të kryer për NDI Maqedonia e Veriut si pjesë e veprimit global të NDIsë. NDI Maqedonia e Veriut vendosi ta bëjë këtë hulumtim, për shkak të ngritjes së zërit të shumë politikaneve femra. Në lidhje me dhunën ndaj tyre në politikë, bazuar përvojës apo prej dëshmisë të ngjarjeve! Ka pasur diskutime që dhuna ndaj grave në politikë nuk njihet si e tillë, se ajo është përhapur gjerësisht. E autorët e krimit të qëndrojnë të pa ndëshkuar, dhe kjo ndikon në mënyrë negative në pjesëmarrjen e grave në politikë. NDI Maqedonia e Veriut synonte të merrte njohuri të dorës së parë, për atë se çfarë është në të vërtetë situata në partitë politike, dhe të promovonte dialog mbi qështjet prioritare për të përmisuar politikat dhe/ose protokollet institucionale në lidhje me diskriminimin, dhunën dhe kërcënimin ndaj grave në proceset politike.

Metodologjia

Ky hulumtim u nis nga Instituti Nacional Demokratik (NDI) për të vlerësuar manifestimet dhe praktikat e dhunës ndaj grave në partitë politike në Maqedoninë e Veriut. Instituti i Ohrit kreu hulumtimin dhe përpiloi raportin fillestar. Ky raport u shqyrtua dhe u finalizua nga Françeska Binda, Kryetare e Binda Consulting International. Në zgjedhjen e partive politike për pjesëmarrje në këtë vlerësim, hulumtuesit zbatuan konsideratë të veçantë për të siguruar një përfaqësim të gjerë dhe të saktë. Konsideratat e tilla ishin diversiteti etnik i peizazhit vendor politik dhe relevanca e partive për skenën politike e zgjedhore të vendit. Si rezultat, NDI zgjodhi dhjetë parti politike që përfaqësojnë në mënyrë të barabartë blloqet politike etnike shqiptare dhe maqedonase. Këto janë të shënuara më poshtë¹ si vijon:

- Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM)
- VMRO - Partia Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)
- Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)
- Aleanca për Shqiptarët (ASh)

¹ Partitë janë të radhitura sipas rezultateve të zgjedhjeve të fundit të Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare 2020

- Alternativa (Alternativa)
- Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)
- Lëvizja BESA
- Rindërdimi demokratik i Maqedonisë (DOM)
- Partia Liberal Demokrate (LDP)
- Partia e Re Social Demokrate (NSDP).

Hulumtimi u zhvillua nga qershori deri në gusht të vitit 2020. Mbledhja e të dhënave u vonua nga mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare me 15 korrik, 2020. Prandaj, pjesëmarrësit kryesorë të hulumtimit ishin të zënë në fushatën zgjedhore për tre javë para zgjedhjeve dhe të pamundësuar për të marrë pjesë në hulumtim. Sidoqoftë, koha e shkurtër midis procesit zgjedhor dhe diskutimeve në fokus grupe mundësoi që pjesëmarrësit e shumtë të evokojnë dhe të ndajnë perspektiva dhe përvoja të reja dhe kështu të kontribuojnë në rëndësinë e diskutimeve.

Një kufizim i mëtejshëm i hulumtimit ishte paraqitja e pandemisë COVID-19, e cila bëri të domosdoshme kontaktin virtual dhe të largët për të respektuar udhëzimet e NDI-së mbi distancën fizike, duke parandaluar takimet personale. Intervistat dhe fokus grupet u kryen, në distancë, duke përdorur mjete për takime virtuale.

Hulumtimi përdori burime primare dhe sekondare, me theks të veçantë në kryerjen e një rishikimi të dokumenteve të ndryshme dhe kontaktin me palët kryesore partiake të interesuara për një hulumtim cilësor. Mjetet për hulumtim cilësor që janë përdorur janë pjesë e metodologjisë dhe materialeve të zhvilluara nga NDI brenda kornizës së nismave të saja globale, *Fito me gratë: Plani global i veprimit dhe jo pjesëmarrjes në dhunë: Vlerësimi i dhunës ndaj grave në partitë politike*.

Sondazhe

Studiuesit hartuan një sondazh gjithëpërfshirës, me 40 pyetje për gratë dhe një sondazh me 27 pyetje për burrat. Një numër total prej 200 anëtarëve të partisë në mënyrë të pavarur iu përgjigjën sondazhit në internet midis 1 dhe 10 korrikut 2020. Në bashkëpunim me partitë politike, NDI identifikoi të anketuarit si përfaqësues gjeografik dhe etnik nga anëtarësia e secilës parti.

Sondazhet hulumtuan pikëpamjet dhe perceptimet e anëtarëve të partisë për:

- Pranueshmëria e sjelljeve të çrregullta ndër personale brenda partisë;
- Sfidat dhe pengesat në lidhje me përparimin e grave brenda partisë politike;
- Ndjeshmëria e grave në pozicione të ndryshme brenda partisë; dhe
- Përvoja, kuptimi, njohja dhe pranimi i dhunës politike ndaj grave.

	Partia Politike	Gratë	Burra	Total
Sondazhe	Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM)	10	10	20
	VMRO - Partia Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)	10	10	20
	Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)	10	10	20
	Aleanca e Shqiptarëve (ASh)	10	10	20
	Alternativa (Alternativa)	10	10	20

Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)	10	10	20
Lëvizja BESA	10	10	20
Rindertimi Demokratik i Maqedonisë (DOM)	10	10	20
Partia Liberal Demokrate (LDP)	10	10	20
Partia e Re Social Demokrate (NSDP)	10	10	20
	100	100	200

Aneksi i këtij raporti jep përgjigjet e plota nga të dy sondazhet. Ku pyetjet janë të njëjta ose të ngjashme, përgjigjet tregohen në një tabelë për të bërë të mundur krahasimin më lehtë. Pyetjet që janë të ndryshme janë paraqitur në tabela të veçanta. Në secilën tabelë, jepet numri i të anketuarve dhe përqindja e përgjigjeve.

Intervista të thelluara

Midis 22 qershorit dhe 04 korrikut 2020, studiuesit kryen 20 intervista të thella me femrat dhe meshkujt udhëheqës të partive politike. Intervistat zgjatën nga 45 deri në 60 minuta. Shumica e grave të intervistuar ishin kryetare të degës së grave në partitë e tyre. Të anketuarit meshkuj ishin drejtues të lartë të partisë (nënkryetar, sekretar i përgjithshëm, ose shef i qendrës kërkimore të partisë).

	Partia Politike	Gratë	Burra	Total
Intervista të thelluara	Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM)	1	1	2
	VMRO - Partia Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)	1	1	2
	Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)	1	1	2
	Aleanca e Shqiptarëve (ASh)	1	1	2
	Alternativa (Alternativa)	1	1	2
	Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)	1	1	2
	Lëvizja BESA	1	1	2
	Rindertimi Demokratik i Maqedonisë (DOM)	2	0	2
	Partia Liberal Demokrate (LDP)	1	1	2
	Partia e Re Social Demokrate (NSDP)	1	1	2
	11	9	20	

Fokus Grupet

Hulumtuesit kryen dhjetë fokus grupe vetëm me gra nga e njëjta parti në mes të 6 dhe 25 gushtit 2020, detajet janë më poshtë:

	Partia Politike	Gratë	Total
Fokus grupet	Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM)	11	11
	VMRO - Partia Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)	9	9
	Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)	9	9
	Aleanca e Shqiptarëve (ASh)	8	8
	Alternativa (Alternativa)	8	8
	Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)	8	8
	Lëvizja BESA	9	9
	Rindertimi Demokratik i Maqedonisë (DOM)	9	9
	Partia Liberal Demokrate (LDP)	10	10
	Partia e Re Social Demokrate (NSDP)	8	8
	89	89	

Hulumtuesit grumbulluan të gjitha të dhënat kryesore të mbledhura nga sondazhet, intervistat dhe fokus grupet dhe identifikuan grupe tematike kryesore për të prezantuar gjetjet. Për të mbrojtur privatësinë e të gjithë pjesëmarrësve në vlerësim, ky raport nuk atribuon asnjë citat të drejtpërdrejtë bazuar në përkatësinë e partiave.

Analiza përqendrohet në tre shkaqet themelore të dhunës ndaj grave në politikë, siç shpjegohet në metodologjinë e NDI:

1. *Shkaqet institucionale*: Mungesa e mekanizmave institucionalë, ligjeve ose politikave që parandalojnë dhunën ose kërcënimin e dhunës ndaj grave politikisht aktive. Kjo gjithashtu përfshin mungesën e ligjeve ose politikave që mbrojnë viktimat e kësaj dhune, dhe të normave ose strukturave që adresojnë dhunën ndaj grave brenda institucioneve politike ose që promovojnë mbrojtjen e udhëheqjes/pjesëmarrjes së grave.
2. *Shkaqet socio-kulturore*: Këto burojnë nga normat diskriminuese gjinore, përfshirë edhe ato që kufizojnë gratë në sferën private dhe privilegjojnë burrat si politikanë nga natyra. Ato bazohen gjithashtu në “normalizimin” e dhunës në përgjithësi dhe dhunës ndaj grave në veçanti. Ato mund të përfshijnë sa dihet në përgjithësi për dhunën ndaj grave në politikë dhe nëse është shoqërisht e njohur dhe e pranueshme.
3. *Shkaqe individuale*: Këto përfshijnë nëse njerëzit e kuptojnë apo njohin dhunën ndaj grave aktive politikisht, si dhe i referohen mungesës së mundësive, njohurive ose burimeve në dispozicion të grave në politikë.

Konteksti: Përfaqësimi politik i grave në Maqedoninë e Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut ka përparuar në çështjen e barazisë gjinore, veçanërisht në politikë. Numri i grave të zgjedhura në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Edhe pse ka edhe shumë për të rrugëtuar për të arritur përfaqësim të barabartë në **legjislaturën kombëtare**, futja e kuotave ka ndryshuar peizazhin politik në Parlament. Sipas nenit 64 të Kodit zgjedhor, “në të gjitha listat e kandidatëve për deputetë në Parlament, të dorëzuara për zgjedhjet parlamentare, të paktën 40 për qind të kandidatëve duhet t’i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar. Këta kandidatë duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjithë listën - në çdo të tretin pozicion në listë, duhet pasur edhe një kandidat plotësues nga gjinia më pak e përfaqësuar në secilën gjysmë të listës” (Ndryshimet e Kodit zgjedhor 2015, 44).² Për ilustrim, në vitin 2019, Parlamenti i Maqedonisë së Veriut përfshinte 45 gra të deleguara nga parti të ndryshme politike me 120 vende në dispozicion, ose 38.3 për qind. Në vitin 2020, numri arriti në 47 delegate femra,³ 21 përfaqësuese të Koalicionit të LSDM-së (nga 46), 17 nga Koalicioni VMRO (nga 44), pesë nga BDI (nga 15) dhe katër nga Koalicioni Aleanca për shqiptarët/Alternativa (nga 12)

Në mungesë të kërkesave ligjore për pozitat ekzekutive, gratë vazhdojnë të jenë të nën përfaqësuar në **qeveri** në nivelin nacional dhe lokal. Në qeverinë e mëparshme të vitit 2017, nga 22 ministri, katër gra mbanin pozicione ministrore. Në vitin 2020, megjithëse ka më pak ministri, katër gra mbeten në poste ministrore (15.3 për qind e kabinetit). Sipas një studimi të vitit 2019 mbi pjesëmarrjen politike të grave në Maqedoninë e Veriut,⁴ qeveria dështoi të zbatojë programin e saj 2017-21 mbi përfaqësimin e barabartë gjinor. Qeveria emëroi vetëm 19 gra (ose 11.18 për qind) në funksione të larta qeveritare. Gratë përbënin vetëm 25 për qind të drejtorëve të përgjithshëm ose sekretarëve shtetërorë (katër në numër).

Kodi i ri zgjedhor gjithashtu solli rritje në përfaqësimin e grave në **nivelin lokal**. Edhe pse ka përparim në përqindjen e grave këshilltare në këshillat lokalë komunalë, ka vetëm gjashtë gra kryetare të komunave nga 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit (81 gjithsej). Në zgjedhjet lokale të vitit 2017, nga 260 kandidatë për kryetar komune, vetëm 15 ishin gra; një rritje e vogël nga 2013, kur vetëm katër gra u zgjodhën kryetare bashkie (26 gra kandidatë nga gjithsej 339 kandidatë). Gratë aktualisht drejtojnë 15 nga 81 këshilla komunalë.

Konteksti: Pjesëmarrja e grave në partitë politike në Maqedoninë e Veriut

Si portier për aspirantët politikë, partitë politike po mundohen në përpjekjet e tyre për të arritur përfaqësim të barabartë në organet e brendshme organizative. Tri parti politike kanë një grua udhëheqëse (DOM, PEP21 dhe Zëri i Maqedonisë). Burrat drejtojnë të gjitha partitë e tjera aktive politike, megjithëse gratë shërbejnë si zëvendës ose nënkryetarë të tetë partive. Vetëm VMRO-DPMNE nuk ka një grua në nivelin më të lartë të udhëheqjes, pavarësisht se ka dy nënkryetarë (meshkuj).

Komisioni ekzekutiv i VMRO-DPMNE ka gjithsej 25 anëtarë, nga të cilët pesë janë gra. Organi më i lartë i LSDM-së, Bordi ekzekutiv, përbëhet nga 16 anëtarë, nga të cilët nëntë janë gra. Në organin më të lartë të NSDP, Bordi ekzekutiv, nga 21 anëtarë, tetë janë gra. Bordi ekzekutiv i LDP-së përbëhet nga

² http://aa.mk/WBStorage/Files/izboren_zakonik.pdf

³ <https://www.sobranie.mk/segashen-sostav-2020-2024.nspk>

⁴ [Women's Political Participation in North Macedonia](#)

18 anëtarë, nga të cilët katër janë gra. Organi më i lartë i BESA-s është Udhëheqësia qendrore, i cili ka 24 anëtarë, nga të cilët gjashtë janë gra. Nga tetë pozicionet kryesore drejtuese në Aleancë, dy mbahen nga gra. Udhëheqësia qendrore e PDSH-së ka një total prej 30 anëtarësh, nga të cilët shtatë janë gra. BDI ka përfaqësimin më të ulët të grave në udhëheqësinë e saj qendrore, pasi që katër nga 40 anëtarë janë gra. DOM udhëheq me përfaqësimin e grave te partitë politike, pasi që 11 nga 19 anëtarët e Bordit ekzekutiv të saj janë gra.

Pothuajse të gjitha partitë politike në Maqedoninë e Veriut kanë struktura të ndara të brendshme për gratë si një “union”, “organizatë”, “kuvend” ose “forum” i grave, dhe partitë e tjera janë në proces të krijimit të këtyre strukturave. Këto organe artikulohe në statutet e shkruara të partive. Ekzistenca e organeve të tilla, brenda strukturës së partisë, shihet nga shumë si diçka thelbësore për forcimin e zërave të grave në shoqërinë maqedonase dhe për të përmirësuar pjesëmarrjen politike të grave. Qëllimi kryesor i këtyre strukturave është rritja e vetëdijes publike, diskutimi dhe propozimi i rregulloreve të ndërlidhura me gjininë brenda partive si në nivelin lokal ashtu edhe në atë nacional dhe të ndërmarrin veprime specifike për afirmimin e grave në një shkallë shoqërore dhe politike.

Seksionet e grave të gjitha partitë politike angazhohen në mënyrë aktive në aktivitete të profilit të lartë për të promovuar pjesëmarrjen e grave në politikë dhe për të nxjerrë në pah çështje që lidhen me gjininë, shpesh me mbështetjen e qartë dhe publike të udhëheqjes së partisë. Të gjitha sektorë të grave brenda partive politike kanë degë lokale aktive, duke luajtur role kritike në sensibilizimin gjinor të anëtarëve të partive dhe ndërtimin e kapaciteteve të grave me aktivitete bazë, funksione organizative dhe mbështetëse në nivelin lokal, veçanërisht gjatë zgjedhjeve. Për shembull, organizatat e grave të dy partive më të mëdha kanë rrjetet më të gjera të strukturave lokale, me degë në pothuajse çdo komunë .

Unioni i grave i VMRO-DPMNE-së është i përkushtuar në forcimin e kapacitetit të grave udhëheqëse brenda partisë në një nivel lokal. Partia ka krijuar një komision për barazinë gjinore dhe çështjet e ndjeshme ndaj gjinisë. Rregulloret e LSDM mandatojnë Forumin e grave të partisë të promovojë barazinë, aktivitetin politik, statusin dhe përfshirjen e grave brenda partisë dhe në një nivel kombëtar në të gjitha sferat e jetës së tyre shoqërore dhe ekonomike. Për më tepër, Forumi ka kërkuar 50 për qind përfaqësim të grave në listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare. Nga strukturat e saja, ajo ka një nënkryetare femër dhe një grua nënkryetare të partisë (nga gjithsej katër). Forumi i Grave i LDP-së promovon përfaqësimin e barabartë dhe përparimin në udhëheqësi duke zbatuar limite dy-vjeçare të mandatit për pozicionet e forumit. Kanë përfaqësim të barabartë të grave në strukturat e saja më të larta udhëhëse të partisë - dy gra nënkryetare nga të katër. Organizata e grave të NSDP ka mandatuar një përfaqësim minimal prej 30 për qind gra në të gjitha organet e partisë, e cila më vonë u shtua edhe në statutin partiak. Partia ka dy nënkryetare gra nga tre gjithsej.

BESA nuk e ka zyrtarizuar ende Forumin e saj të grave (e planifikuar për kongresin e ardhshëm të partisë), megjithëse në mënyrë funksionale, ka pesë koordinatore rajonale dhe kryetare të degëve lokale. Forumi i saj i grave ka qenë gjithashtu i zëshëm për shtyrjen e 40 për qind të përfaqësimit të grave në strukturat e partisë. Kryetarja e Forumit të grave të BESA është automatikisht një nënkryetare e partisë (nga gjithsej katër) siç është rasti me Alternativa, statuti i Forumit të Grave të së cilës do të zyrtarizohet në Kongresin e saj të ardhshëm të partiak. Dy nga katër nënkryetarët e partisë janë gra.

Forumit i Grave i BDI-së ka një Sekretariat për mundësi të barabarta të angazhuar për arritjen e të paktën 40 për qind të grave në të gjitha strukturat e partisë. Megjithëse aktualisht ka një grua nënkryetare të partisë (nga katër gjithsej), Statuti nuk përcakton që ajo duhet të jetë kryetare e Forumit të grave. Forumi i grave i PDSH-së i kushtohet pjesëmarrjes aktive dhe adekuate në vendimmarrje brenda

partisë dhe qeverisë, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Forumi i Grave ka një degë në çdo bashki ku ka një degë partie. Presidenti i saj është gjithashtu një nga nënkryetarët e partisë (dy gra nga katër gjithsej).

Që nga themelimi i saj në 2006, gratë kanë udhëhequr DOM, duke promovuar një platformë për barazinë dhe emancipimin e grave në nivelin lokal. DOM gjithashtu ka një Forum të veçantë të grave, i cili zgjedh komisionet e saj në një nivel lokal që, nga ana tjetër, kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset demokratike të organeve më të larta në parti. Forumi ka një profil të lartë brenda partisë, duke marrë pjesë në aktivitete të barazisë gjinore dhe duke filluar një fushatë për kuota prej 50 për qind për përfaqësimin e grave në organet politike, postet ministrore, kryetarë komune, borde ekzekutive dhe organe të tjera shtetërore.

Aleanca për shqiptarët ka formuar një Kuvend të grave, e cila është shumë e zëshme në aktivitetet dhe përfaqësimin në nivelet lokale dhe kombëtare. Në përputhje me rregulloret e partisë, kryetarja e Kuvendit të grave duhet të shërbejë edhe si nënkryetare e Aleancës. Sidoqoftë, në kohën e shkrimit, ky rregull nuk zbatohet, e që është një arsye që Kryetarja e Kuvendit të grave dha dorëheqje nga të gjitha funksionet në parti në 16 shtator, 2020. Arsyet që ajo dha janë: mos përfshirja e grave anëtare të Kuvendit në strukturat e partisë, mos arritja e përfaqësimit të paktën 40 për qind të grave në organet e partisë (vetëm tre nga 30 në nivelin qendror janë gra) dhe nuk koordinon ose këshillon me Kuvendin e grave kur zgjedhin kandidatë [femra] për listat e kandidatëve, duke e bërë kështu ekzistencën e Kuvendit të grave dhe pozitën e kryetares së saj të pa vlefshëm.

Gjetjet e vlerësimit: Dokumentet relevante të partisë

Hulumtuesit ekzaminuan dokumentet e dhjetë partive politike për të kuptuar shkallën deri në të cilën partitë kanë zyrtarizuar angazhimin e tyre për barazinë gjinore dhe njohjen e nevojës për të adresuar dhunën. Statutet dhe kodet e sjelljes së partive politike janë mjete formale për të përcjellë vlerat e partisë dhe për të drejtuar sjelljen e anëtarëve brenda organizatës. Ndërsa ekzistenca e dokumenteve nuk do të thotë që standardet përdoren ose zbatohen, ato janë hapi i parë në zhvillimin e një kulture respekti, duke siguruar për viktimat e dhunës një mbështetje zyrtare. Meqenëse koncepti i dhunës politike është i panjohur ose i keqkuptuar në mesin e shumë aktivistëve në Maqedoninë e Veriut, disa pjesëmarrës iu referuan udhëzimeve të pashkruara verbale që promovojnë standardet etike të sjelljes demokratike dhe respektit, kur u pyetën në lidhje me udhëzimet zyrtare të partive që adresojnë dhunën ndaj grave. Sigurisht, pa udhëzime të shkruara, është e pamundur të verifikohet se si përdoren komunikimet verbale për të luftuar dhunën ndaj grave në parti.

Statutet e partive

Secila nga dhjetë partitë politike në Maqedoninë e Veriut ka një statut që shpjegon vlerat qendrore, qëllimet, platformën dhe organet e partisë. Shtatë parti politike kanë përfshirë dispozita në statutet e tyre që përcaktojnë angazhimet e tyre për barazi gjinore, përfaqësim të barabartë gjinor ose kundër dhunës së bazuar në gjini. Më konkretisht, neni 16 i statutit të ri të VMRO-DPMNE thekson se partia është plotësisht e vetëdijshme për barazinë gjinore dhe është e përkushtuar për të siguruar përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave në të gjitha organet dhe strukturat e partisë. LSDM, në nenin 2 të statutit të saj, thekson krijimin dhe forcimin e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave në Maqedoninë e Veriut. Neni 70 i statutit të LSDM kërkon të paktën 40 për qind të përfaqësimit të grave në të gjitha organet e partisë. DOM, në nenin 1 të statutit të saj, flet për të drejtën për barazi për të gjithë qytetarët në Maqedoninë e Veriut, pavarësisht nga gjinia e tyre. Statutet e partive të

LDP-së dhe NSDP-së nuk kanë dispozita specifike të shkruara në lidhje me barazinë gjinore, por duke iu referuar më përgjithësisht të drejtave të njeriut dhe barazisë. Neni 41 i statutit të NSDP nënvizon se duhet të ketë një përfaqësim prej 30 për qind të dy gjinive në të gjitha organet e partisë.

Në Aleancën e Shqiptarëve (ASH), ka disa dispozita në statut për barazinë gjinore dhe përfaqësimin e barabartë të grave brenda organeve të partisë. Sipas nenit 18 të Statutit, partia i është përkushtuar luftës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit dhe është e përkushtuar për emancipimin e grave dhe barazinë e plotë gjinore. Si rezultat, partia përpiqet të përfshijë të paktën 40 për qind përfaqësimin e grave në të gjitha organet e partisë siç thuhet në statut.

Statuti i Alternativës thekson nocionin e barazisë gjinore si një aspekt të vlefshëm të platformës së partisë. Dokumenti përsërit se Alternativa nuk do të tolerojë asnjë formë diskriminimi, urrejtjeje ose dhune bazuar në fe, racë, etni dhe gjini. Më tej vazhdon se Alternativa do të përpiqet të mbrojë të drejtat themelore të njeriut, duke respektuar të gjitha ligjet dhe traktatet ndërkombëtare të krijuara për të garantuar barazinë dhe lirinë. Dokumenti i partisë thotë qartë se është e përkushtuar që të ketë të paktën 30 për qind të grave përfaqësuese në organet më të larta të partisë (neni 58). Në statutin e saj, BESA angazhohet për qëllimet e ndërtimit të një kombi demokratik dhe gjetjen e zgjidhjeve për të gjitha format e diskriminimit mbi baza racore, fetare, etnike dhe gjinore, si dhe zbatimin e ligjeve për të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Është theksuar qartë në nenin 9 të statutit, që BESA është e përkushtuar për të përmirësuar statusin e grave si një e drejtë universale, e pamohueshme. Neni 16 i statutit të BDI-së përqendrohet në përmirësimin e pozitës politike të grave për të marrë pjesë në të njëjtën mënyrë në proceset e vendimmarrjes së vendit.

Deri sa statuti i PDSH-së nuk përmend dhunën ndaj grave, Rregullorja e forumit të grave të PDSH-së ka një referencë të qartë për dhunën ndaj grave. Neni 5 i Rregullores së forumit thotë se ky organ do të promovojë aktivitete për parandalimin e krimit të organizuar, trafikimin e grave, dhe të gjitha llojet e dhunës ose veprimeve të paligjshme ndaj grave. Partia ka siguruar 30 për qind të përfaqësimit të grave në organet e partisë, kandidatët për zgjedhje dhe bartësit e funksioneve publike si në nivelin lokal ashtu edhe në atë kombëtar.



Megjithëse barazia gjinore dhe përfaqësimi i barabartë, në raste, përcaktohet në statutet e partive politike, nuk përmendet dhuna ose mbrojtja e grave nga dhuna. Për më tepër, nuk ka mekanizma brenda dokumenteve të partisë që rregullojnë ose sanksionojnë anëtarët e partive politike dhe zyrtarët që kryejnë dhunë.

Një analizë e hollësishme e statutit të partive në lidhje me sjelljet që çojnë në përjashtim ose sanksionim nga partia tregon se secila parti politike ka sanksione për lloje të caktuara të sjelljes nga anëtarët e partisë. Asnjë nga sanksionet e parashikuara të partive nuk përmend dhunën me bazë gjinore, megjithëse disa theksojnë se sjellje të caktuara janë të papranueshme. VMRO-DPMNE, LSDM, DOM, Aleanca dhe BDI nuk e përcaktojnë qartë termin “sjellje të papërshtatshme” që mund të çojë në përfundimin e mundshëm të anëtarësimit. Neni 12 në statutin e LDP-së, thotë se anëtarësia e partisë do të përfundojë në rastin kur personi me veprimet e tij ose të saj po dëmton reputacionin e partisë. NSDP ka të njëjtën terminologji lidhur me reputacionin e partisë (neni 8). BESA gjithashtu përqendrohet në sjelljen shkatërruese të lidhur ngushtë me reputacionin dhe statusin e partisë (neni 14). Alternativa thekson autoritetin e partisë në vend të reputacionit, por arsyeja e ndërprerjes së anëtarësisë mbetet e njëjtë - sjellja shkatërruese që mund të ndikojë negativisht në autoritetin e partisë (neni 14). PDSH përdor gjuhë paksa të ndryshme pasi që ndërprerja do të pasojë vetëm në rast të shkëlqes serioze të rregulloreve dhe obligimeve ndaj partisë si anëtar (neni 12).

Kodet e Sjelljes

Asnjë nga dhjetë partitë politike, të vlerësuara në këtë hulumtim, nuk kanë kode formale të sjelljes që rregullojnë sjelljen e anëtarëve ose mbrojnë gratë aktiviste nga dhuna. Gjatë intervistave, përfaqësuesit e LSDM-së, DOM-it dhe LDP-së treguan se partitë e tyre planifikojnë të hartojnë dhe prezantojnë kode të sjelljes, duke përfshirë dispozitat për të parandaluar çdo formë të dhunës. Funkionarët e LSDM-së janë të detyruar të nënshkruajnë një Deklaratë nderi para se të marrin ndonjë post, duke u zotuar të mos përdorin fyerje, shpifje, dhunë dhe kërcënime, gjuhë urretjeje, ose të japin informacione ose premtime të rreme. Alternativa është partia e vetme politike që ka një Kod Etik, duke ndaluar posaçërisht një zyrtar të partisë të kryejë çfarëdo abuzimi seksual ose ndonjë akt që shoqërohet me një abuzim ose ngacmim të tillë (neni 5).

Grave të anketuara, dhe të intervistuarve dhe pjesëmarrësve në fokus grupet, u kërkua të reflektojnë mbi udhëzimet e partisë që rregullojnë sjelljen midis anëtarëve të partisë. Objektivi kryesor i kësaj pyetjeje ishte të mësonte më tepër për nivelin e vetëdijes për ekzistencën dhe shkallën e arritshmërisë ose dobisë së mekanizmave brenda partiakë kundër sjelljeve të dhunshme ndër personale. Pothuajse një e treta (31 për qind) e grave që iu përgjigjën sondazhit nuk e dinin nëse partia e tyre ka udhëzime për të rregulluar sjelljen e anëtarëve dhe pothuajse gjysma (43 për qind) vuri në dukje se nuk ekzistojnë mekanizma të tillë. Ndërsa 26 për qind e të anketuarve pranojnë se ekzistojnë mekanizma të tillë, gati gjysma e tyre nuk e dinë se si janë zyrtarizuar. Për më tepër, 62 për qind nuk janë të vetëdijshëm nëse janë të arritshëm, të dobishëm, efektivë, ose nëse dhe sa shpesh përdoren mekanizmat.



Hulumtuesit gjithashtu shqyrtuan ekzistencën e dokumenteve të shkruara për të rregulluar sjelljen e anëtarëve gjatë intervistave dhe diskutimeve në fokus grupe. Kishte perceptime dhe përgjigje të përziera (madje edhe brenda të njëjtës parti) nëse ekzistojnë mekanizma për rregullimin e sjelljes në formën e kodeve të sjelljes ose rregulloreve në statute dhe në çfarë forme ose nëse ato janë zbatuar ose janë efektive.

Po, ekziston një kod i brendshëm i sjelljes. Partia jonë politike ka përcaktuar qartë një ideologji që në mënyrë eksplicite hedh poshtë, dënon dhe ndalon të gjitha format e dhunës. I anketuari në intervistë

Kodi i brendshëm i sjelljes aktualisht është në fazën e hartimit. Tani për tani është një rregull i pashkruar. Për momentin nuk ekziston zyrtarisht, por ka udhëzime të pashkruara se çfarë është e pranueshme dhe çfarë jo. I anketuari në intervistë

Ekziston një kod i brendshëm i sjelljes. I anketuari në intervistë [53, dega rurale]

Ekziston një kod i brendshëm i sjelljes që rregullon abuzimin verbal dhe llojet e tjera të dhunës drejtuar grave. I anketuari i fokus grupeve [48, dega urbane]

Asnjë nga partitë politike nuk përmend ose sanksionon sjellje të dhunshme ndaj grave ose dhunë me bazë gjinore në dokumentet e tyre zyrtare. Shumë nga të anketuarit pranuan se kjo ishte hera e parë që ata menduan për nevojën për të mbrojtur gratë në politikë. Deri tani, ngacmimet dukeshin pjesë normale e jetës së tyre politike.


Gjetjet e vlerësimit: Pengesat për pjesëmarrjen e grave në parti

Vlerësimi zbuloi se gratë përballen me pengesa si për pjesëmarrjen e tyre në politikë në përgjithësi, ashtu edhe për të aspiruar për pozicione udhëheqëse brenda partive të tyre politike. Siç citohen nga numër i madh i të anketuarve, pengesat kryesore të veprimtarisë politike të grave janë **vlerat** mbizotëruese **patriarkale** dhe paragjykimet pasuese që nënkuptojnë se gratë nuk janë të përshtatshme për pjesëmarrje aktive në sferën publike, dhe veçanërisht në politikë. Për më tepër, analiza e pikëpamjeve të anketuarve tregon se vlerat patriarkale janë një tregues kompleks që shfaqet si një shkak i nënkuptuar i sfidave të tjera, të tilla si në **kufizimet kohore** dhe **mungesa e mbështetjes nga familja**.

Paragjykimi shoqëror është pengesa më e madhe. Ekziston një pikëpamje që gratë që merren me [politikë] janë joparimore, kanë moral të lirshëm dhe ky imazh i mundshëm pengon shumë gra nga përfshirja politike. Gjithashtu, para se një grua të hyjë në një marrëdhënie serioze ose martesë, ajo është e përfshirë në mënyrë aktive, siç ka qenë rasti në partinë tonë; por sapo ajo të hyjë në një marrëdhënie të ngushtë ose martesë, ajo tërhiqet. Është e vështirë të thuash se sa gra me cilësi kemi humbur pasi që u martuan. Nuk mund të spekuloj për arsyet; ato mund të jenë burri dhe pikëpamjet e tij, roli tradicional i grave, mungesa e kohës ose mungesa e mbështetjes nga familja. I anketuar në intervistë

Gratë shqiptare u nënshtrohen stereotipave dhe paragjykimeve që na bëjnë të ndjehemi inferiorë si institucionalisht ashtu edhe në lidhje me pozicionet drejtuese dhe, fatkeqësisht, ne kënaqemi me përfaqësimin tonë në listat e kandidatëve për deputetë. Në një farë mënyre, është një mendim i brendshëm që gratë me moral të mirë nuk duhet të jenë aktive politikisht,

gjë që prek gratë e reja që aspirojnë të merren me veprimtari partiake. I anketuar i fokus grupeve [38, dega urbane]



Një aspekt tjetër domethënës që buron nga vlerat patriarkale dhe ndikon në qasjen e grave në mundësi dhe përparimin e tyre brenda partive politike është **dikotomia midis asaj publike dhe private**. Shkalla e pjesëmarrjes në domenin publik shpesh varet nga koha në dispozicion dhe autonomia për ta përdorur atë. Shumë gra janë të kufizuara në pjesëmarrjen e tyre politike për shkak të rolit socio-kulturor që u caktohet në familje, gjë që sjell mungesë kontrolli mbi jetën e tyre.

Unë kam një përvojë 25 vjeçare në politikë, jam përfshirë që kur isha një grua e re... Do të filloj me faktorin e kohës dhe ekuilibrin midis jetës familjare dhe obligimeve profesionale, në krye të së cilës vjen aktiviteti politik. Sado që pretendojmë të jetojmë në një shoqëri progresive, shpërndarja e roleve dhe përgjegjësisë brenda familjes ende peshon shumë në anën e gruas. Kështu, sa herë që një grua vendos të merret me politikë, një organizatë të shoqërisë civile ose ndonjë formë tjetër e aktivitetit publik, ajo rrezikon të merr kohën e saj të ndarë për familjare ose atë personale.
I anketuar i fokus grupeve [55, dega urbane]

Megjithëse udhëheqësia e partisë beson në përshtatshmërinë e të gjitha roleve për gratë, kjo nuk është një ndjenjë e përbashkët për anëtarësinë e partisë. Shumica mendojnë se vendi i gruas është sfera private, shtëpiake, se roli i saj është të kujdeset për shtëpinë dhe se politika nuk është vendi për të. Duke pasur parasysh mendësinë [shoqërore], kjo është e kuptueshme.
Mashkull i anketuar në intervistë

Megjithëse të anketuarit kishin perceptime të ndryshme në lidhje me dominimin e veçantë të kësaj çështje në provincë dhe zona rurale, përfaqësues të shumë fokus grupeve të degëve më të vogla komunale të partive ranë dakord që rolet e tyre private ndikojnë në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në jetën publike.

Unë përfaqësoj [një komunë në kryeqytet] dhe gjithmonë them se është e lehtë të jesh grua në [partinë time politike] në këtë komunë; çështja e sfidave dhe pengesave për pjesëmarrje janë mbase më të relevante në provinca, dhe posaçërisht në zonat rurale, ku përkrahja e partisë dhe anëtarësimi është çështje e njohurive të rëndomta.
I anketuar i fokus grupeve [46, dega urbane]

Nëse një grua [në një zonë rurale] hyn në hapësirat e partisë, ajo etiketohet si lavire. ... Kur ishte koha për të krijuar forumin e grave në [zonën rurale], si koordinatore e forumit, unë fillova të telefonoj gratë dhe t'i pyes ato nëse duan të bashkohen. Njëra më tha: "Unë do të jap numrin e burrit tim, flit me të; nëse ai më lejon, unë do të bashkohem". Ai nuk e la atë. Dhe ky nuk ishte një rast i izoluar.
E anketuara e fokus grupeve [49, dega rurale]

Në aktivizmin tim politik 26-27 vjeç, kam arritur në përfundimin se gratë në provincë kanë nevojë për mbështetjen tonë. Ato veprojnë në zona ku burrat janë shumica absolute dhe vendimmarrës të padiskutueshëm. Gratë atje po luftojnë jo vetëm stereotipat dhe paramendimet e imponuara nga burrat, por edhe paragjykimet e shprehura nga gratë tjera që mbajnë akoma fjalën e vjetër të patriarkale të “çfarë je duke bërë e duke u përzier në politikë kur vendi juaj është në shtëpi”. Lutja ime për të gjitha gratë aktiviste afatgjate, si unë, është që të marrin në konsideratë drejtimin e burimeve partiake jo vetëm në avancimin e të rinjve por edhe për të ndihmuar gratë në këto zona. **E anketuara e fokus grupeve [53, dega urbane]**


Të qenit të hapur në mënyrë të parezervuar me të cilën shumë pjesëmarrës të grupeve të fokusit ndanë përvojat e tyre, pa shfaqjen e një treguesi tjetër thelbësor dhe shumë të diskutuar - atë të perceptimit **mungesës së mbështetjes dhe solidaritetit nga një grua për një grua tjetër**. Në përgjithësi, ndarjet e klasave, gjinive, etnive dhe të tjera theksohen më shumë kur ka mungesë të ndjeshmërisë dhe solidaritetit brenda një grupi për të diskriminuarit. Shoqëria dhe solidariteti midis grave janë, për këtë arsye, thelbësore në transformimin e pabarazive të ngulitura midis burrave dhe grave dhe midis vetë grave, dhe në përmbysjen e vet kontekstit patriarkal të zhvillimit.

Perceptimi im është se një grua do të mbështesë shumë më shumë një burrë se sa ajo do të mbështesë një grua tjetër. E anketuara e fokus grupeve [42, dega urbane]

Në fund të ditës, pasi të kemi identifikuar një problem, duhet të pyesim veten se cila është pjesa jonë si kontribuues të mundshëm të këtij problemi. Ne [gratë] duhet ta pyesim veten me të vërtetë se pse na mungon kohezioni dhe solidariteti për të arritur [përfaqësim më të mirë në pozitat udhëheqëse]. Ne nuk mund t’ua hedhim fajin kolegëve tanë të partisë; ata e mbështesin më shumë njëri-tjetrin. E anketuara e fokus grupeve [39, dega urbane]

Në fakt, gratë [brenda partisë] shpesh mund të veprojnë si frenuese; ato jo vetëm që tërheqin mbështetjen e tyre dhe refuzojnë të promovojnë cilësitë dhe meritat e një kolegeje partiake që i mundësojnë asaj të ngjitet në shkallët e udhëheqjes, por ato theksojnë në mënyrë aktive çdo arsye pse ajo nuk duhet të përparojë. E anketuara e fokus grupeve [56, dega rurale]

Duke reflektuar në atë që ndodhi kohët e fundit, kur [një deputet i sapo mandatuar mashkull përdori gjuhë urrejtjeje në një status në Facebook për të kritikuar një deputete grua], vura re se vetëm dy gra qëndruan në mbështetjen e saj. Pasi lexova për këtë, u motivova të kontribuoj duke shprehur gjithashtu mbështetjen time. E anketuara e fokus grupeve [42, dega urbane]



Stereotipat socio-kulturore të roleve të grave informojnë në mënyrë të pashmangshme çështjen se cilat pozicione brenda partisë politike janë më të përshtatshme për to. Veçanërisht, shumica dërrmuese e të anketuarve në intervistë pajtohen se gratë mund të përmbushin çdo rol të partisë politike që janë të përshtatshëm për një anëtar të partisë mashkull. Sidoqoftë, perceptimet dhe përvojat e dhëna kryesisht gjatë diskutimeve në fokus grupet sugjerojnë një realitet tjetër.

Vetëm pozitat në listat e kandidatëve që sigurisht se do të humbin [në zgjedhje] janë të rezervuara për gratë. Për shembull, kur këto pozicione u ishin shpërndarë grave nëpër njësitë zgjedhore, u bë e ashtu që gratë të përfshiheshin vetëm aty ku ishte e sigurtë që nuk do të merrnin një mandat. E anketuara e fokus grupeve [29, dega rurale]

Roli i sekretarit të përgjithshëm do të ishte mbase e tepërt. Ky pozicion kërkon një punë të madhe në terren dhe një investim masiv në kohë, dhe nuk do të ishte i përshtatshëm për një grua. Në të gjitha partitë politike në vend, nuk ka pasur kurrë një grua në këtë pozitë. I anketuari në intervistë mashkull

Ne [gratë] trajtohem si një numër i duarve në vendimmarrje dhe shihemi si zbuçurime për partinë politike; pozicioni më i lartë që ne mund të aspirojmë të arrijmë është mbase ai i nënkryetarit - por jo atë të udhëheqësit. Kur bëhet fjalë për burrat, ata kanë një rrugë të drejtpërdrejtë drejt komisioneve qendrore dhe vendimmarrjeve të rëndësishme të cilat prekin partinë. Nga ana tjetër, gratë, së pari duhet të marrin pjesë në forumin e grave dhe të filtrohen shumë herë para se njëra prej tyre të vendoset e treta në listën e kandidatëve për deputetë. Ky nuk është rasti vetëm në partinë tonë; për shembull, të gjithë ministrat nga [partia rivale politike] deri më tani kanë qenë burra sepse nuk ka rregullore që të paktën një nga tre ministrat duhet të jetë një grua. ... Në partitë politike [të vendit] tonë, ne shihemi si sasi, jo si cilësi. E anketuara e fokus grupeve [55, dega rurale]

Kjo mungesë e dukshmërisë politike, e shoqëruar me vlerat socio-kulturore që qëndrojnë në themel të saj, shpesh merren dhe riprodhohet nga mediat. Të anketuarit mendojnë se edhe pse **mbulimi nga mediat (shoqërore)**, veçanërisht gjatë periudhës elektorale, nuk e kufizon ekspozimin e tyre, ndihmon në përjetësimin e modeleve dhe stereotipave të asaj se çfarë duhet të jetë një "grua vërtetë e arritur".

Ndërsa jemi aktualisht në një periudhë pas zgjedhore, tashmë janë bërë propozime për gratë ministre. Unë jam e bindur që reagimet e para do të drejtohen në pamjen e tyre fizike, sjelljes së tyre gjatë seancës konstituive; këto do të pasohet me përkujtime se sa 'të arritura' janë ato si gra dhe nëna; dhe mbase, në fund, një përmbledhje e shkurtër e arritjeve të tyre të kaluara politike. Kjo nuk u ndodh burrave. E anketuara e fokus grupeve [48, dega urbane]

Ne duhet të dukemi mirë; të jemi të veshur modest, por bukur dhe me shije; të jemi femërore; të sigurohuni që ne të mos reagojmë në një mënyrë 'burrërore'; të kujdesemi për tonin tonë, që të mos dukemi impulsive ose agresive. Pra, sigurisht, gratë mendojnë se këto standarde të dyfishta në mënyrë efektive ndërprejnë avancimin e tyre politik. E anketuara e fokus grupeve [44, dega rurale]

Shoqërimi i tipareve stereotipike mashkullore me karakteristikat përcaktuese të një lideri të suksesshëm nuk është aspak një praktikë e re në kornizën socio-kulturore dhe, si parazgjedhje, në media. Tipare të tilla si ambicia, racionaliteti, serioziteti, kontrolli, vendosmëria dhe konkurrenca kanë mbizotëruar në profilizimin e një udhëheqësie të mirë. Në të kundërt, këto aspekte rrallë shoqërohen me sjellje që konsiderohen tipike femërore: ndjeshmëri, emocion, butësi, afekcion. Megjithatë shumë nga të anketuarit

theksuan se gratë janë, në përgjithësi, “me takt, negociatore më të mira, më pak të prira për ryshfet dhe më pak të korruptuara”, ato ende perceptohen se nuk kanë “stomakun për të qenë udhëheqëse”. Këto praktika konsiderohen të dekurajojnë shumë gra në arritjen e pozicioneve të dukshme brenda partisë ose të jenë candidate. Ato kanë një efekt më të madh kur ekspozimi në media (ose ekspozimi në rrjetet sociale) mund të rrezikojë reputacionin e grave dhe të ndikojë në jetën e tyre personale dhe publike.

P10. A ka pasur ndonjëherë raste kur jeni ndeshur me pengesa ose sfida për aftësinë tuaj për t’u ngjitur në hierarkinë e udhëheqjes brenda partisë tuaj? Nëse po, çfarë? Zgjedhje e shumëfishtë	
Përgjigje	Përqindja 100%
Unë nuk përballem me ndonjë pengesë ose sfidë	47%
Po unë jam përballur me pengesa ose sfida	31%
Mungesë e kohës ose burimeve financiare	11%
Mungesë e mbështetjes nga udhëheqësit e partisë ose anëtarët e tjerë të partisë	8%
Mungesa e mbështetjes nga familja	1%
Unë nuk kam kapacitet të mjaftueshëm, trajnim ose arsimim	1%
Tjetër	1%

Gjetjet nga vlerësimi: Dhuna kundër grave në partitë politike

Hulumtimi zbulon se DHKG në politikë dhe partitë politike është e kuptuar pak tek aktivistët politik në Maqedoninë e Veriut. Një vështrim i përgjithshëm del nga grupet e fokusit në lidhje me përvojat specifike me incidente të dhunës kundër grave në partitë politike është që diskutimi përfitoi nga një pasqyrë fillestare e definimit të termit dhe shtrirjes dhe sqarimit lidhur me aktet e shumta që përbëjnë dhunën. Hulumtuesit nxorrën këtë përshtypje nga disa nga fokus grupet e para. Para se të tregonin një akt të dëshmuar ose të përjetuar të dhunës, disa pjesëmarrës shprehën dyshime nëse akti mund të konsiderohej bile si një formë e dhunës.

Sigurisht, pa udhëzime të shkruara, është e pamundur të verifikohet se si përdoren komunikimet verbale për të luftuar dhunën ndaj grave në parti. Kam një dilemë në lidhje me temën e këtij diskutimi.... Dhuna ndaj grave në partitë politike është një kategori e rrjedhshme dhe ndonjëherë është e vështirë të njihet sepse nuk ka tiparet e dhunës klasike [theksimi i shtuar nga autori]; në vend të kësaj, ne [gratë] përballemi me forma të fshehta që shpesh shprehen si ndërthurje inteligjente të stereotipave dhe manipulimeve të krijuara për të parandaluar gratë që të përparojnë në politikë. Anketuar në fokus grupi [58, dega urbane];

Aktivistët politikë që morën pjesë në këtë hulumtim konfirmuan se disa prej tyre kishin përjetuar ose dëshmuar forma të zakonshme të DHKG, përfshirë dhunën psikologjike, kërcënimet dhe detyrimet, ose dhunën fizike, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre të partisë politike. Në të dyja rastet, të anketuarit ishin të lirë, joformalisht, të ndajnë incidente të dhunës seksuale brenda partive të tyre, nuk dëshironin që ti kujtonin ato gjatë intervistimit për këtë hulumtim. Ngurrimi për të shkëmbyer informacion në lidhje me dhunën seksuale është i zakonshëm në bashkësitë tradicionale dhe konservatore me qëndrime të forta patriarkale. Friga nga stigmatizimi, turpi, ose viktimizimi dytësor shpesh do të thotë që viktimat heshtin për dhunën dhe vendosin kundër kërkimit të përkrahjes ose raportimit të incidenteve.

Friga nga stigmatizimi, turpi, ose viktimizimi dytësor shpesh do të thotë që viktimat heshtin për dhunën dhe vendosin kundër kërkimit të përkrahjes ose raportimit të incidenteve. Incidentet

specifike të dhunës të raportuara në intervistat dhe grupet e fokusit zbulojnë se DHKG në politikën e Maqedonisë së Veriut varion nga dhuna psikologjike te ajo fizike. Këto incidente përfshijnë:

- Përhapja e hollësive intime ose personale dhe fotografive në mediat sociale, pastaj të marra dhe ndara tutje me platformat onlajn të lajmeve.
- Shpifja duke krijuar foto-montazhe dhe duke i publikuar ato në profilet e personifikuara në mediat sociale (Facebook dhe Instagram).
- Konfrontimi fizik (shtyerj).
- Bullizmi.
- Ngacmimi i anëtarëve të ngushtë të familjes duke përfshirë ndjekjen fizike, kërcënimet verbale në person dhe në mediat sociale.
- Bullizmi në vendin e punës si rezultat i përkatësisë politike/partisë ose qëndrimit publik
- Gjuha e urrejtjes në internet dhe jashtë tij.
- Ofendime që etiketojnë pjesëmarrjen politike të një gruaje si një praktikë jomorale.
- Trajtimi diskriminues në pjesën e masmediave: që marrin në pyetje jetën e tyre personale sjelljen e tyre seksuale, dukjen fizike dhe veshjen e tyre.

Manifestime të ndryshme të tre kategorive të cituara më së shpeshti që janë të ilustruara në citatet më poshtë:

Dhuna psikologjike:

Kam pësuar abuzime të ndryshme për ngritjen e zërit tim për realitetet shqetësuese shoqërore në mjedisin tim.

Kohët e fundit, fotografitë e mia private dhe të burrit tim u manipuluan dhe u shpërndanë në rrjetet sociale pa pëlqimin tonë.

Fyerjet dhe gjuha e urrejtjes në komente ishin të padurueshme.

Për t'i bërë gjërat edhe më keq, ata u morën dhe u paraqitën në disa faqe të lajmeve në internet. Anketuar në fokus grup [43, dega urbane]

Kërcënimet dhe detyrimi:

Në periudhën para se deputetët të votonin mbi ndryshimin e emrit [të vendit], disa deputetë përjetuan shantazhe dhe kërcënime anonime për jetën e familjeve të tyre, me nekrolog dhe gjithçka. Femër e anketuar [55, dega urbane]


Ndërsa po kandidohesha për Kryetare të Komunës [komunë në kryeqytet], inboksi im u stërbush me fotografi të syve, me mesazhe të tilla si “kujdes” ose “Unë po të shikoj”. Anketuar në fokus grup [58, dega urbane]

Dhuna fizike:


Isha e sulmuar në këshillin e qytetit përderisa po përpiqesha të gjiroja seancën. Isha me fat që nuk pësova lëndime - shpëtova me një mëngë këmishë të grisur - por u shqetësova shumë që, nga 50 personat e pranishëm në dhomë, vetëm një person pa se çfarë ndodhi. Veçanërisht u trondita nga mungesa e reagimit nga gazetarët - njerëz që zakonisht shohin gjithçka. Anketuar në fokus grup [46, dega urbane]

Lidhur me rrethanat e incidenteve, ndërsa shumica e të anketuarve pajtohen se vorbulli i fushatës zgjedhore ose ngjarjeve të tjera të rëndësishme politike (p.sh. vota të konsiderueshme, nominime të brendshme të partisë ose pozicione të jashtme të kandidatëve) janë katalizatorë të zakonshëm për veprime të dhunshme, kohërat më të qeta nuk do të thonë mungesë e dhunës. Pjesëmarrësit

e grupeve të fokusit pajtohen se dhuna kibernetike, në të gjitha format e saj, është një çështje e vazhdueshme që përjetëson veten në çdo rast kur një politikane grua flet për të shprehur pikëpamjet e saj ose të partisë së saj, duke “tërhequr kështu vëmendjen e ripërtërirë tek vetja e saj”.



Të pyetur se cilin rol ose pozicion partie kishin kur ndodhi dhuna, gratë e anketuara identifikuan mjedisin e tyre lokal si vendin e parë ku hasën në incident(e) të dhunës.



Për sa i përket **autorëve** të këtyre veprave, ekziston një model ngjashmëri në shumëllojshmërinë e atyre që janë përgjegjës për ushtrimin e dhunës ndaj grave politike:


- Burra nga e njëjta parti politike me ideologji konfliktuale,
- Burra nga parti politike rivale që mbrojnë interesat e partisë,
- Anëtarët e rangut më të lartë të së njëjtës parti politike,
- Kllasterë aktivistësh të brendshëm ose të jashtëm që ushtrojnë dhunë nga rrjetet e profileve të rreme të mediave sociale,
- Burra dhe gra nga një parti rivale në role mbikëqyrëse në vendin e punës.

Këshilltarja jonë komunale anëtare [komunë në provincë] është sulmuar verbalisht disa herë nga një këshilltar mashkull nga një parti kundërshtar, vetëm sepse ajo ngriti zërin e saj për problemet e vërteta komunale. Gjithashtu, e njëjta grua kishte fotografi familjare private të shpërndara në mediat sociale me fyerje dhe kërcënime. Anketuar në fokus grup [57, dega urbane]

Kam qenë direkt e ekspozuar ndaj abuzimit të pushtetit nga mbikëqyrësit në vendin tim të punës, në mënyrë që të më ndalojnë lirinë time të shprehjes dhe fjalës si dhe kufizimin

e drejtpërdrejtë të të drejtave të mia për të kryer detyrat e mia të përditshme të punës. Anketuar në fokus grup [55, dega urbane]

Unë isha dëshmitare kur u kërcënua gruaja udhëheqëse e organizatës time komunale. Kam përjetuar linçim nga një turmë gjatë protestave, fyerje dhe pështyerje dhe kjo ishte nga gratë. E gjitha ishte për shkak të pozicioneve politike që unë përfaqësoj. Anketuar në fokus grup [48, dega urbane]



Një perceptim i shquar në lidhje me autorët ishte se në dhunën kibernetike (ngacmimi, gjuha e urrejtjes, shpifja dhe kërcënimet në mediat sociale), autorët ishin shpesh grupe të organizuara aktivistësh ose mbështetësish të partisë që bënin fushatë nga disa profile të rreme (në dy raste, të anketuarit vlerësuan këtë numri të jetë afërsisht 70 profile).

E dija që këta njerëz ishin shumë të organizuar dhe kishin këtë pajisje të ngjashme me NASA-n në vendet nga ku po operonin. Anketuar në fokus grup [55, dega urbane]

Një anëtare e forumit tonë [ish-kandidate në zgjedhje] u ngacmua në internet vetëm sepse ajo kritikoi [disa nga] politikën e partisë [së saj]. Pas zgjedhjeve e njëjta u ofendua dhe u ngacmua seksualisht në internet dhe kur ajo zbuloi publikisht mesazhet, ajo ishte viktimë e një dhune edhe më të madhe në internet dhe fotografive të montuara të saj. Anketuar në fokus grup [29, dega rurale]

Këto raporte tregojnë një kultivim të mundshëm të mentalitetit të bandave kibernetike. Shpejtësia e informacionit dhe shtrirja e përhapjes e zmadhojnë ndikimin.

Pavarësisht nga identifikimi i kryerësve si gra dhe burra, është thelbësore të theksohet marrëdhënia e kryerësit me të anketuarin. Të anketuarit raportuan raste të detyrimit të familjes [të afërmve dhe miqve] lidhur me aktivizmin politik të viktimës, udhëheqës të degëve lokale të partive të koalicionit, aktorë të tjerë jo-politikë që e urrejnë aktivizmin politik të viktimës. Raportohet se qëllimi është që të përjashtohet gruaja nga arena politike ose të dekurajohet aktiviteti dhe zëri i saj politik deri në pikën ku shpifet për karrierën dhe reputacionin e saj dhe ajo detyrohet të tërhiqet.

Unë kam qenë dëshmitare e dhunës midis anëtarëve të familjes së ngushtë që i përkasin partive të ndryshme politike. Kjo ndikoi në marrëdhëniet familjare, në ndërprerjen e lidhjeve familjare dhe armiqësinë e përkeqësuar. Anketuar në fokus grup [63, dega urbane]

Pas 12 vitesh karrierë në [fushën sociale] kur hyra në politikë u përballa me gjykim dhe dekurajim nga rrethina ime. Ata thoshin, “Pse ke hyrë në politikë, ke kapacitet, aftësi, vlera morale, nuk je për politikë.” Por doja të bëja diçka të mirë për të gjithë, kështu që qëndrova këtu. Anketuar në fokus grup [42, dega rurale]

Një pjesë e komenteve që dëgjova kur vendosa të merrem aktivisht me politikën iu drejtuan burrit tim - “të gjithë do ta kenë gruan tënde, pse e le të shkojë atje ku mblidhen të gjithë burrat, gratë e bukura nuk duhet të jenë në politikë”. Si familje, kemi duruar shumë presione dhe kërcënime në atë kohë. Anketuar në fokus grup [46, dega rurale]

Ndikimi dhe raportimi i dhunës ndaj grave në partitë politike

Disa zyrtare të udhëheqësisë së partive të intervistuar për këtë vlerësim sugjeruan që problemet e partive politike janë pjesë e një dileme më të gjerë shoqërore. Sidoqoftë, ato gjithashtu besojnë se nuk janë në gjendje të ndryshojnë “fotografinë e madhe”.

Elementi i dhunës është i ngulitur në kulturën e Maqedonisë së Veriut, që kërkon veprim nga palë të shumta të interesit. Ne si vend, veçanërisht si parti politike, kemi probleme sistematike me dhunën në politikë, veçanërisht ndaj grave. Përfaqëson një pengesë të madhe për të hyrë në politikë; me pasoja për reputacionin e grave, por edhe për reputacionin e partive. Anketuar në intervistë

Shoqëria në përgjithësi është problem. Ekzistojnë standarde të dyfishta dhe kjo u bë normale. Është kufizim për pjesëmarrjen e grave në politikë. Ka një mendim se një mashkull mund të ngel ministër edhe me gabime dhe mangësi, por nëse është grua, nuk ka tolerancë, ajo menjëherë diskualifikohet nga politika. Anketuar në intervistë

Udhëheqësit e partive të intervistuar për këtë hulumtim pranojnë efektet që ka dhuna ndaj grave në punën e tyre në parti, duke minuar përfitimet e shumta që sjell pjesëmarrja e grave. Të pyetur për të shqyrtuar ndikimin e dhunës mbi gratë individualisht dhe mbi vetë partinë, ishte e qartë se ekziston vetëdije në lidhje me efektet afatshkurtra dhe afatgjata të dhunës mbi gratë politike dhe partitë politike. Të anketuarat përmendën ndikimin në mjedisin e punës brenda partisë, efektet në lidhshmërinë politike, imazhin dhe reputacionin, pjesëmarrjen dhe aktivizimin e anëtarëve femra, ambiciet e anëtarëve të partisë, vetëvlerësimin, pjesëmarrjen dhe vizibilitetin dhe përshtypjen për anëtarët aspirues, ose rekrutimin e kadrove të reja. Sidoqoftë, shumica e të anketuarave folën për “një parti”, “duke folur përgjithësisht”, duke mos i lidhur efektet e dhunës me partinë e tyre politike.

Një dhunë në parti do të kishte një efekt negativ në anëtarët gra, por edhe në të gjithë partinë gjithashtu, madje duke i bërë ato të humbin zgjedhjet dhe anëtarësimet e grave.. Anketuar në intervistë

Sigurisht, nëse do të kishte një dhunë, kjo do të kishte një efekt të dëmshëm si në udhëheqësinë e partisë ashtu edhe në anëtarësimin; do të krijonte një neveri ndaj politikës dhe tërheqjen e anëtarësisë dhe humbjen e besimit në parti, duke rezultuar me pasoja katastrofale. Anketuar në intervistë

Dhuna gjithashtu do të ndikonte në ideologjinë e partive. Nëse do të kishte dhunë kundër grave në parti, kjo do të rezultonte me efekt të menjëhershëm, duke i kthyer ato kundër partisë dhe duke kërkuar përgjegjësi. Anketuar në intervistë

Nëse do të kishte një dhunë ndaj grave në parti, ajo do të kishte efekt të menjëhershëm domino mbi gratë e tjera anëtare dhe kjo mund të rrezikojë pozicionin, madje edhe vetë funksionimin e partisë. Anketuar në intervistë

Në një pakicë rastesh, të anketuarat pranuan efektin negativ nga rastet e dhunës ndaj grave politike brenda partisë së tyre politike. Komentet nga të anketuarat sugjerojnë që transparenca dhe veprimi i menjëhershëm nga udhëheqësia luajnë një rol vendimtar në perceptimin e anëtarëve të partisë për aftësinë e partisë për t'iu përgjigjur dhunës.

Po, kishte ndikime në drejtim të frikës dhe ndjenjës se gratë nuk janë të mbrojtura, por fakti që udhëheqësia nuk qëndroi në heshtje dhe nuk mbuloi rastet, i ktheu efektet negative në pozitive, si për viktimat ashtu edhe për anëtarët e tjerë gjithashtu (Anketuar në intervistë)

Pa marrë parasysh se sa e dhimbshme është të flasësh për këto raste brenda partisë, ne gjithmonë kemi insistuar në një kulturë të komunikimit të hapur. (Anketuar në intervistë)

Vlerësimi sugjeron që **ndikimi i dhunës tek gratë politike** mund të jetë i thellë: së pari dhe më kryesorja, në një nivel personal, gratë po përjetojnë dhunë përderisa po veprojnë në emër të partive të tyre përkatëse politike ose për shkak se janë në një parti politike. Është e dëmshme për shëndetin mendor dhe mirëqenien e përgjithshme të viktimës, veçanërisht nëse ato ndiejnë se nuk kanë mbështetjen aq të nevojshme.

Kjo kishte ndikuar në shëndetin tim, në familjen time, marrëdhëniet me burrin tim, fëmijët e mi u ishin nënshtruar presioneve dhe gjykimeve për shkakun tim. Kam frikë për jetën time dhe jetën e familjes sime. Nuk e dija se deri ku do të shkonte; por nuk kisha asgjë për të humbur [politikisht] dhe kurrfarë zgjedhje tjetër përveç se të vazhdoja të luftoja. Anketuar në fokus grup [55, dega urbane]

Gratë politike janë subjekt i mobingut dhe linçimit në publik - ato monitorohen vazhdimisht për çdo hollësi nga pamja dhe veshjet, flokët dhe qëndrimi i tyre. Është kaq e tmerrshme psikikisht, e padurueshme, prandaj shumë prej tyre demotivohen. Anketuar në fokus grup [46, dega urbane]

Kam përjetuar dhimbje, isha e lënduar psikikisht dhe jam e sigurt se nëse do të vazhdojmë [të punojmë] në këto kushte nuk do të kemi asnjë grua në politikë. Anketuar në fokus grup [45, dega urbane]

Për më tepër, duke iu nënshtruar një presioni të vazhdueshëm dhe kërcënimit të dhunës kjo mund të dëmtojë lirinë e shprehjes së viktimave, të nxisë vetëcensurimin, të kufizojë autonominë ekonomike të viktimave dhe të parandalojë pjesëmarrjen e plotë të viktimave në jetën publike.

Anësore është që i vë shumë faj vetes time për postimin e asaj që bëra [në mediat sociale]. Unë nuk kam absolutisht asnjë ndjenjë të keqe për reagimet që kam marrë ose për njerëzit që reagueshan - shumë prej tyre janë ende miqtë e mi të ngushtë. Por unë patjetër që mendoj dy herë dhe përpiqem të parashoh para se të postoj ndonjë gjë tani. Anketuar në fokus grup [39, dega urbane]

Lash punën time para se të mësoja se do të më përjashtonin. E lash sepse ishte bërë e padurueshme. Anketuar në fokus grup [26, dega urbane]

Këshilli [ku u bë dhuna] është një bashkësi e etniteteve të ndryshme, ku nga 31 pjesëmarrës 10 janë gra. Ato janë normalisht të pazëshme; paramendoni se sa të motivuara ato do të ishin të flasin pas asaj që më ndodhi mua. Anketuar në fokus grup [46, dega urbane]

Ka raste fatkeqe në partitë politike [të tjera] ku e dimë se një numër i grave mjaft kompetente janë rrëzuar dhe kjo ndikoi në vendimet e grave të tjera që dëshironin t'i bashkëngjiten partisë. Anketuar në fokus grup [44, dega rurale]

Të anketuarit manifestojnë vetëdije se ndikimi i dhunës ndaj grave shtrihet në të gjithë vijat e partisë, por konkludojnë se në politikë, duhet të jesh i përgatitur të përballësh me presione të rënda. Internalizimi i shkaqeve themelore të dhunës drejtuar ndaj grave ka edhe një efekt tjetër në vetëvlerësimin dhe motivimin e grave aktive politikisht, duke rezultuar në tërheqje të përkohshme ose të përhershme nga politika.

Është për të ardhur keq që kemi parë gra nga partitë e tjera politike, të cilat kishin kapacitet dhe profesionalizëm, por prapë u shkatërruan politikisht, gjë që pa dyshim kishte ndikim në gratë e tjera që mendonin të bashkoheshin me ndonjë parti politike. Anketuar në fokus grup [58, dega urbane]

Është fatkeqe, por në shoqërinë tonë kemi paragjykime të vazhdueshme që ndikojnë dhe demotivojnë gratë aktive në politikë. Kjo gjithashtu ndikon mbi gratë tjera që kanë aspirata për të marrë një rol aktiv në ndonjë parti politike, cilëndo parti politike. Anketuar në fokus grup [42, dega urbane]

Secili që është i gatshëm të futet në politikë duhet të jetë i vetëdijshëm dhe i gatshëm për presionin që vjen me atë pozitë. Anketuar në fokus grup [63, dega urbane]

Kur sulmohem, gjithmonë pyes veten, çfarë bëra për të provokuar këtë sulm ndaj meje. E kuptoj që të gjithë kemi prejardhje të ndryshme dhe mund të keqkuptohemi. Anketuar në fokus grup [44, dega rurale]

Pavarësisht, rastet sugjerojnë gjithashtu që mekanizmi mbizotërues i trajtimit të pasojave të incidenteve specifike është këmbëngulja, e shprehur nga shumë nga të anketuarat si një angazhim i vendosur ndaj përkushtimit të tyre politik dhe misionit të tyre brenda partisë së tyre.

Ndikimi psiqik është i pamohueshëm, por ne kemi arritur ta kapërcejmë atë duke besuar në potencialin tonë. Ne jemi intelektuale dhe gjithmonë do të jemi të zëshme për të drejtat dhe meritat tona në karrierë përpara përpjekjeve të panumërta për të na përjashtuar nga skena politike. Anketuar në fokus grup [55, dega urbane]

Përkohësisht u largova nga politika. Por nuk mund të qëndroja anash e pazëshme për shumë gjatë. Anketuar në fokus grup [39, dega urbane]

Nuk hoqa dorë [nga politika], ia kushtova punën time strukturave të partisë, duke punuar për të parandaluar diskriminimin. Anketuar në fokus grup [39, dega rurale]

Disa të anketuara vunë në dukje se një faktor që i ndihmon ato të ballafaqohen me dhunën është “era në shpinë” - solidariteti dhe mbështetja e ofruar nga koleget e tyre politikane. Ky faktor është jetik

në nxitjen e aleancës dhe shoqërisë, promovimin e marrëdhënieve konstruktive të punës bazuar në interesa të përbashkëta dhe dërgimin e një mesazhi pozitiv për gratë e partisë dhe gratë e ardhme anëtare të partisë. Solidariteti dhe mbështetja shpesh vijnë nga gratë e partive të ndryshme.

Mjaft e kundërt, incidenti pati një efekt pozitiv mbi gratë e tjera në parti në atë që forcoi ndjenjën e bashkësisë dhe përkatësisë midis tyre. Ishte gjithashtu e dobishme që ngriti pyetjet që kanë qenë të maskuara për kohë të gjatë për rolet e grave në parti. Femër e anketuar në intervistë

Kam marrë mbështetje masive nga shoqet e mia [gratë], të cilat ishin të lumtura të diskutonin opsionet në lidhje me veprimet që mund të bëja. ...Ishte inkurajimi nga koleget e mia femra që më motivoi të dilja nga heshtja dhe pasiviteti. Anketuar në fokus grup [45, dega urbane]

Kjo do të thoshte shumë për mua, porositë e heshtura dhe private të mbështetjes që mora, duke parë që këto gjëra u ndodhin edhe grave të tjera të partive politike më bënë kokëfortë dhe të vendosur për të qenë e zëshme. Anketuar në fokus grup [46, dega urbane]

Vlerësimi sugjeron një korrelacion midis përvojave të viktimave dhe **modeleve të raportimit**. Perceptimet e përgjithshme midis pjesëmarrëseve janë se raportimi është i ulët, kryesisht për shkak të arsyeve që vijnë:


- Mungesa e besimit në praninë ose efektivitetin e legjislaturës dhe mekanizmave të shtetit,
- Frika e 'provokimit' të përshkallëzimit të dhunës, dhe
- Frika e publicitetit negativ, turpërimit dhe stigmatizimit shoqëror (viktimizimi dytësor).

Ndërgjegjësimi i kufizuar për gamën e gjerë të akteve që përfshin dhuna, mund të përbëjë një arsye tjetër të nënkuptuar për nivelet e ulëta të raportimit. Edhe pse ato zakonisht njohin shumicën e formave të ndryshme të dhunës si të tilla, të anketuarat shpesh deklarojnë se e gjitha është pjesë e lojës së politikës.

Mendoja se e gjithë kjo është normale; pasi që ke vendosur të hysh në politikë duhet të jesh e gatshme për të gjitha llojet e gjërave, kjo është thjesht se si është e bërë politika; duhet të kalitesh. Anketuar në fokus grup [48, dega urbane]


Nocioni që dikush duhet të "kalitet" dhe të durojë gjithçka që has në politikë është i zakonshëm përtej vijave të partisë.

Pavarësisht nga incidenti, rezoluta e parë kërkohet brenda rrethit të ngushtë të partisë. Mbi dy të tretat e të anketuarave në sondazh (68 për qind) deklaruan se do të kërkonin një zgjidhje brenda udhëheqësisë së partisë. Shumë gra që morën pjesë në hulumtim theksuan se ato as që raportuan incidentet e dhunës. Mbi një e katërta e të anketuarave thanë se, në atë kohë, ato nuk e njihnin përvojën si të dhunshme, ndërsa të tjerët deklaruan se besonin se ishte normale që një sjellje e tillë të ndodhte në partitë politike.



Nëse nuk keni zgjedhur ta paraqisni rastin ose t'i tregoni ndokujt për incidentit që keni përjetuar, cila ishte arsyeja kryesore, që nuk e keni raportuar? Ju lutemi shënoni të gjitha fushat që janë të vlefshme:

- Nuk mendoja se incidenti ishte formë e dhunës 26%
- Nuk mendoja se incidenti ishte në kundërshtim me ndonjë rregullore të partisë ose mendoja se është gjë normale për partinë time ose për "lojën politike" 17%
- Për shkak se do të ishte gjë e turpshme, nëse do ta paraqisja rastin 3%
- Për shkak se anëtarët tjerë të partisë, të cilat kanë raportuar incidente të tilla, kanë pësuar ndëshkim në vend se të dënohet autori i incidentit 3%
- Meqenëse ishte zgjidhur problemi 17%
- Për shkak se nuk kisha dëshmitarë 7%
- Nga frika e kërcënimeve ose represaljeve kundër meje dhe/ose familjes sime 7%
- Nga frika se po dënohen personat përgjegjës 0%
- Për shkak se më janë kërcënuar personat përgjegjës 0%
- Për shkak se i njoh ose kam lidhje farefisnore me personat përgjegjës 0%
- Për shkak se në partinë time ose në shtetin tim nuk njoh ndonjë mënyrë për ta raportuar këtë lloj të sjelljes 10%
- Tjetër 10%



Disa përcaktues janë mungesa e mbështetjes, gjykimi dhe stigmatizimi nga mjedisi i viktimës, dyshimet se cili do të jetë rezultati. Pyetja ime e parë ishte, a do të arrij ndonjë gjë konstruktive [duke raportuar] apo do të ndez vetëm një zjarr më të madh për veten? Anketuar në fokus grup [55, dega urbane]

Pyetja ime e parë ishte, çfarë vijon? E dija që ekziston një njësi speciale brenda Ministrisë së brendshme që merret me krimin kibernetik - por cilat janë veprimet, masat specifike të tyre? Kjo është pikërisht arsyeja që shumica e grave dekurajohen nga raportimi, sepse procedura është e paqartë. Anketuar në fokus grup [45, dega urbane]

Gjithçka është aq e politizuar; po nëse ai [kryerësi] është një aktivist i shquar i partisë? Unë ende nuk kam dëgjuar dikush që të sanksionohet. Dhe ne shohim se çfarë ndodh në mediat sociale ditë pas dite. Mbi të gjitha, të gjithë kemi familje; gjithashtu si aktivistë, ne i kushtojmë një rëndësi të madhe ruajtjes së një reputacioni të mirë dhe vetë-prezantimit dinjitoz. Kështu që nuk raportojmë. Anketuar në fokus grup [49, dega rurale]


Kur gratë raportuan dhunë, ato iu treguan anëtarëve të ngushtë të partisë, udhëheqësisë së partisë, ose raportuan incidentin në polici. Përgjigjet e ndara ndryshojnë për sa i përket rezultateve. Sidoqoftë, ndjenja e përgjithshme e shumë të anketuarave ishte që është mbajtur një *status quo* ku çështjes nuk i ishte dhënë përparësi ose nuk është çuar tutje nga autoritetet.

Ndërsa [partia] nuk ka mekanizma për të përjashtuar një anëtar në bazë të ideologjive të tyre, sulmuesit janë ndaluar nga organet drejtuese të partisë dhe ka proces gjyqësor që është duke vazhduar kundër tyre. Anketuar në intervistë

Unë raportova rastin tim [të dhunës në internet] në polici; kur kërkova se a ka zhvillime të reja, më thanë se grupi i njerëzve që kisha raportuar është zbuluar se operon nga vendet e huaja dhe kështu kishte shumë pak gjë për të bërë. Kjo ishte kjo. Anketuar në fokus grup [45, dega urbane]

I raportova policisë, ata sugjeruan që unë të ngre padi private dhe kështu bëra, por prokuroria publike nuk hapi një rast. Asgjë nuk ka ndodhur deri më sot. Anketuar në fokus grup [26, dega urbane]

Kujt ia keni treguar ose raportuar incidentin? Ju lutemi shënoni të gjitha fushat që janë të vlefshme:




A kishte ndonjë pasojë për kryerësin(t) e veprave?				
Ju lutemi të shënoni të gjitha që vlejné.				
	GRA të anketuara		BURRA të anketuar	
	përqindje(%)	Numrim(N)	përqindje (%)	Numrim (N)
Nuk kishte kurrfarë pasojë për kryerësin(t) e veprave	63%	17	25%	25
Kryerësi është qortuar privatisht	18%	5	2%	2
Kryerësi është qortuar publikisht	0%	0	0%	0
Kryerësi është përjashtuar nga partia	0%	0	2%	2
Kryerësi u detyrua të kërkoj falje	4%	1	4%	4
Kjo shkaktoi që kryerësi të humb pozitën ose ndikimin, ose të largohet nga partia	0%	0	1%	1
Kryerësi u sanksionua	0%	0	1%	1
Kjo shkaktoi që kryerësi të jetë i mbuluar në mënyrë negative në mediat, duke përfshirë ato në internet, sociale në radio	4%	1	2%	2
Tjetër	11%	3	7%	7
Nuk di	0%	0	56%	56

Siç është e treguar në tabelë, pyetja e njëjtë lidhur me ndikimin mbi kryerësin ose zgjidhjen e incidentit të dhunës ndaj grave politike ka dhënë rezultate të ndryshme tek të anketuarit femra dhe meshkuj. Në kontrast, shumica e burrave nuk e dinin nëse kishte pasojë apo jo. Shumica e grave raportuan se nuk kishte asnjë pasojë për kryerësin(it).

Përgjegjësia për parandalimin e dhunës ndaj grave

Në përgjithësi, shumica e të anketuarve besojnë se udhëheqësia e partisë mban përgjegjësinë kryesore për parandalimin dhe trajtimin e formave të ndryshme të dhunës brenda partive të tyre, dhe gjithashtu dhe të partive politike rivale.



Për tu ndjerë të mbrojtur, anëtarët e partisë politike mbështeten në nivelet më të larta të partisë për udhëzime, mekanizma adekuat dhe gjithëpërfshirës për të monitoruar dhe kontrolluar sjelljen, dhe organet funksionale të menaxhimit. Të anketuarit për këtë hulumtim identifikuan mungesën e mekanizmave dhe strukturave të brendshme që adresojnë dhunën ndaj grave në politikë, duke sugjeruar që partitë politike nuk po i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme kësaj çështjeje komplekse. Në raste të izoluar, një grup i vogël njerëzish brenda rrethit të lidërsipit janë ballafaquar me dhunë, e kanë përmbajtur atë dhe e kanë zgjidhur atë në një mënyrë sa më private ose “diskrete” për të ruajtur imazhin e mirë të partisë. Perceptimi i përgjithshëm ishte që shumë anëtarë nuk kishin njohuri për ekzistencën e rasteve të tilla.

Nëse ndodh një incident i dhunshëm, udhëheqësia duhet të përfshihet në mënyrë aktive dhe ta dënojë ngjarjen pa mëdyshje në mënyrë që të dekurajojë çdo incident të dhunshëm në të ardhmen. Anketuar në fokus grup [57, dega urbane]

Udhëheqësia e partisë ka një përgjegjësi të jashtëzakonshme; por unë besoj se shumë prej tyre qëndrojnë në parandalimin e suksesshëm të dhunës dhe zbatimin e një qasjeje udhëheq me shembuj. Anketuar në fokus grup [45, dega urbane]

Partia nuk është përgjegjëse për çështjet personale dhe konfliktet midis anëtarëve të partisë. Anketuar në intervistë

Udhëheqësia e partisë duhet gjithmonë të mbahet në përgjegjësi. Kur unë iu bashkëngjita partisë politike mu tha se asnjëherë nuk do të jem vetë dhe se do të kem partinë gjithmonë pas meje [për mbështetje]. Kjo ishte vendimtare për mua. Anketuar në intervistë

Shumë të anketuar besojnë se ngarkesa është mbi udhëheqësinë e partisë për të siguruar mbrojtje ligjore dhe mediatike për të gjithë anëtarët që veprojnë ose flasin në emër të partisë. Të anketuarit vunë në dukje se partitë politike shpesh ofrojnë këshilla ligjore dhe ndihmë në rastet e shpifjes, por mbështetje e ngjashme nuk ekziston për të mbrojtur gratë nga dhuna.

Për më tepër, në shumicën e rasteve, gratë u lanë të merreshin me këtë çështje vetëm, privatisht, ose u lanë mënjandë dhe vetëm.

Gratë politikane duhet të ndihen të sigurta dhe të mbrojtura kur veprojnë në emër të partive. Është roli i udhëheqësisë që të sigurojë mbrojtje nga çdo lloj ngacmimi. Anketuar në fokus grup [45, dega urbane]

Kam pritur shumë nga udhëheqësia e partisë sime. Por rezultati ishte ftohja e raporteve dhe ndërprerja e komunikimit [jo vetëm] për anëtarët e partisë por për miqtë gjithashtu. Ndikimi ishte i thellë në jetën time politike dhe personale. Anketuar në fokus grup [55, dega urbane]

Të pyetur për mënyrat e luftimit të kundër dhunës kundër grave brenda partive politike, të anketuarit u fokusuan në rregullat e partisë. Ata sugjerojnë që të vendosen mekanizma për parandalim, por gjithashtu për të sanksionuar sjelljen e pahijshme. Theksi vihet në udhëzimet për adresimin e duhur të çështjeve, të grupuara sipas temës dhe llojit të dhunës.

Të anketuarit janë njëlloj të zëshëm se një luftë efektive kundër DhKG në politikë kërkon një sinergji midis të gjithë aktorëve dhe një nivel të caktuar të pjekurisë politike. Rruga e dëshiruar janë rregulimet së bashku me sanksionet. Sidoqoftë, aktualisht nuk ka institucione ose mekanizma që mund të merren në mënyrë efektive me këtë çështje. Edukimi gjithëpërfshirës mbi dhunën ndaj grave në politikë është gjithashtu i nevojshëm për të zvogëluar stereotipat dhe paragjykimet për të krijuar një atmosferë besimi dhe ndjeshmëri gjinore.

Në shtetin tonë kemi ligje dhe rregullime, por fatkeqësisht ato nuk kanë funksionale dhe prandaj aq shumë gra politikane nuk paraqesin incidentet, ose kur e bëjnë këtë, ato ngelin pa përgjigje nga institucionet. Anketuar në fokus grup [53, dega urbane]


Institucionet nuk janë angazhuar si duhet për të zgjidhur rastin tim [bullizëm në vendin e punës për shkak të aktivizmit politik]. Anketuar në fokus grup [26, dega urbane]

Nuk jam e vetëdijshme për çfarëdo rregullimi që mbron gratë aktive në politikë nga [llojet e ndryshme të] dhunës, as në politikë e as në shoqëri. Anketuar në fokus grup [55, dega urbane]

Mendoj se duhet të ketë ligje të duhura për mbrojtje sidomos për gratë politikane, sepse automatikisht do të zbatohen për partitë politike. Nëse presim që secila parti të përgatisë rregulloret për anëtarët e tyre, nuk do të ketë një zgjidhje uniforme për të gjithë, plus asnjë garanci se ato do të ndiqen nga të gjithë. Anketuar në fokus grup [42, dega urbane]

Duhet pasur rregulla brenda çdo partie. Së pari duhet të punojmë në marrëdhëniet tona të brendshme dhe sjelljet e pastaj gjithçka tjetër. Në çdo parti politike duhet të ekzistojnë rregulla, rregullore dhe kode, pastaj një ligj, rregullime dytësore dhe të mos harrojmë, një edukim i gjerë për të gjithë politikanët. Anketuar në fokus grup [58, dega urbane]

Me përjashtim të udhëheqësisë së partive politike, pjesëmarrësit identifikuan disa aktorë të tjerë përveç “aktorëve të dukshëm” të tillë si **gjyqësori, policia dhe mediat** që ndajnë përgjegjësinë për adresimin e dhunës ndaj grave në partitë politike. Kur u pyetën se sa të gatshëm do të ishin të raportonin dhunën që kanë përjetuar tek autoritete të ndryshme, shumica e grave politikane kategorizojnë aktorët e lartpërmendur. Sidoqoftë, një përqindje marramendëse e 44 për qind do të ndërmarrë një veprim tjetër ose nuk do të vepronin aspak. Një arsye e mundshme për mosveprim është mënyra e pakënaqshme me të cilën po merren rastet sidomos mungesa e pasojave për kryerësit.



Në pikëpamjet e disa të anketuarve, **Klubi i deputeteve** mund të jetë një agjent kryesor në fillimin e ndryshimeve në legjislacionin ekzistues për t'u bërë më gjithëpërfshirës i formave të dhunës dhe masave specifike për parandalimin dhe sanksionimin e tyre. Për më tepër, ministritë përkatëse, të tilla si Ministria e punës dhe politikës sociale, dhe veçanërisht organizatat joqeveritare, u veçuan si ndikuesit kryesorë në krijimin e projekteve edukative dhe të komunikimit me publikun. Mungesa e përgjithshme e ndërgjegjësimit - madje edhe midis grave aktive politikisht - demonstroi se luftimi i dhunës ndaj grave në politikë kërkon një qasje shumëplanëshe me të gjithë palët e interesit.

Duhet të ekzistojë një rregullim i rreptë që do të zbatohet vetëm për gratë aktive në politikë, por edhe ligje që do të rregullojnë më seriozisht abuzimin, fyerjet dhe dhunën, duke filluar nga policia, gjykatat, prokuroria, inspektimi dhe organizatat e grave. Anketuar në fokus grup [49, dega rurale]

Ka ligje që rregullojnë diskriminimin dhe dhunën në familje, por nuk ka asnjë ligj ose rregullore që mbron gratë në politikë drejtpërdrejt. Ka ligje që rregullojnë diskriminimin dhe dhunën në familje, por nuk ka asnjë ligj ose rregullore që mbron gratë në politikë drejtpërdrejt. Gjithashtu, ekziston problemi që gratë nga parti të ndryshme politike nuk mbështesin njëra-tjetrën, që është një minus i madh në luftën kundër dhunës ndaj grave në politikë. Anketuar në fokus grup [62, dega urbane]

Jo gjithmonë ligji është një zgjidhje-ne jemi gjithashtu fajtorë, ne kemi institucione të politizuara, gjyqësor jofunksional dhe asnjë mbështetje nga njëra-tjetra si gra politikane. Anketuar në fokus grup [39, dega urbane]

Nuk di ku të raportoj një dhunë ndaj një gruaje politikane. Ku ta raportoni kur as nuk konsiderohet si vepër penale. Dhuna si e tillë raportohet rrallë, aq më pak ajo politike. Është e vështirë të dëshmohet dhe të sanksionohet. Për më tepër, unë nuk kam besim te institucionet se çështja do të zgjidhet. Anketuar në fokus grup [55, dega urbane]

Përfundim & Rekomandime

Dhuna ndaj grave në politikë është një çështje e keqkuptuar dhe komplekse në Maqedoninë e Veriut. Derisa kuotat dhe aktivitetet e përbashkëta kanë ndihmuar në ngushtimin e hendekut gjinor politik, partitë politike nuk adresojnë dhunën ndaj grave brenda partive të tyre dhe sistemit politik në përgjithësi. Pjesërisht, ky dështim buron nga mungesa e të kuptuarit të asaj se çfarë përbën dhunë. Edhe shumë gra politikisht aktive e konsiderojnë bullizmin, ngacmimin dhe shpifjen si çmimin e natyrës “së vrazhdë dhe të rrënuar” të politikës. Në këtë hulumtim, disa të anketuar nuk e njohën sjelljen e papranueshme brenda partisë së tyre si domosdoshmërisht të dhunshme në krahasim me sjelljen e papranueshme të drejtuar atyre nga jashtë partisë së tyre. Natyra fisnore e veprimtarisë së partisë politike e bën të vështirë për shumë që të besojnë se pala e tyre mund t’i viktimizojë ato.

Edhe kur pjesëmarrësit në hulumtimin tonë njohën dhe artikuluan incidente të dhunshme, ato kanë pak besim se raportimi i tyre do të rezultojë në pasoja për autorët e krimet. Një rishikim i dokumenteve përkatëse të partive zbulon një mungesë të rregullore dhe sanksioneve për sjelljen e dhunshme, që do të thotë se viktimat femra të dhunës kanë pak ose aspak mbrojtje zyrtare. Gratë në partitë politike kanë frikë nga largimi ose izolimi nga bashkëpartiakët e tyre nëse raportojnë dhunë. Ndërsa stereotipat konservatore dhe tradicionale ndikojnë në nivelet e pjesëmarrjes dhe ndikojnë në rolet e grave në partitë politike, ndikimi i dhunës mbi gratë aktiviste ka implikime kritike për integritetin e proceseve demokratike.

Mbajtja e diskutime kuptimplota lidhur me dhunën në bazë gjinore dhe sjellja e brendshme e partive politike janë të ndjeshme dhe sfiduese. Sidoqoftë, diskutimet e fokus grupeve të këtij hulumtimi zbuluan se gratë në partitë politike janë të gatshme të shqyrtojnë shkaqet, efektet dhe mekanizmat për të zbutur DhKG në politikë. Është e qartë se ekziston gatishmëria, pavarësisht nga përkatësia partiake, për të ndërmarrë veprime për të parandaluar, edukuar dhe mbrojtur gratë politikane.

Rekomandime

Shumë nga rekomandimet e mëposhtme vijnë direkt nga diskutimet në fokus grupet dhe intervistat me të anketuarit në këtë hulumtim.

Rekomandime për udhëheqësinë e partive politike

- Më shumë hapje dhe gatishmëri për të diskutuar konceptin e dhunës politike.
- Pranoni ekzistencën e formave të ndryshme të dhunës [përtej fuqisë së tyre] brenda partive të tyre politike.
- Shprehni publikisht vullnetin politik për të trajtuar dhe respektuar dialogun politik në lidhje me DhKG në politikë.
- Organizoni aktivitete të përbashkëta përtej linjave partiake për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të parandaluar dhunën në politikë, veçanërisht ndaj grave politikane.
- Inicimi i procedurave të brendshme brenda partive për të hapur diskutime mbi mekanizmat për rregullimin e sjelljes së anëtarëve, veçanërisht ndaj femrave anëtare.
- Bëni publike dhe të arritshme dokumentet që rregullojnë sjelljen ndërmjet anëtarëve, edukoni anëtarët për ekzistencën e tyre.
- Bëni një rishikim të proceseve të brendshme dhe sjelljes brenda-partiake për të siguruar që kultura e ngacmimit dhe bullizmit nuk tolerohet.

- Merrni parasysh mbrojtjen [ligjore dhe psikologjike] për gratë politike derisa mbajnë poste publike.
- Ndërtoni një kulturë të vazhdueshme dhe publikisht shfaqni respekt dhe sjellje të duhur ndaj të gjitha grave në politikë në përgjithësi, jo vetëm ndaj anëtarëve.
- Zhvilloni një proces të fuqishëm për trajtimin e incidenteve të raportuara brenda partisë që plotëson standardet ndërkombëtare të drejtësisë dhe transparencës, duke krijuar kështu një atmosferë besimi dhe inkurajimi që viktimat e tjera gjithashtu të paraqiten.
- Krijoni një panel ose komision ndërdisiplinor, shumë ekspertësh të përbërë nga anëtarë të partisë politike nga fusha dhe ekspertiza të ndryshme, të gatshëm për të trajtuar çdo ankesë ose incidente të dhunës ndaj grave anëtare të partisë dhe zyrtarëve.
- Krijoni ekipe multidisiplinore lokale ose rajonale për të punuar në zonat urbane dhe rurale me gra nga prejardhje të ndryshme.
- Konsideroni sanksione dhe shkarkim nga funksionet e partisë për anëtarët të cilët janë përfshirë në forma të ndryshme të dhunës.

Rekomandim për degët e grave dhe gratë politike

- Rritja e ndërgjegjësimit brenda dhe informimi i anëtarëve për llojet dhe nën-llojet e ndryshme të dhunës që klasifikohen si të tilla, në mënyrë që t'i njohin dhe t'i raportojnë.
- Siguroni mbështetje dhe informacion për anëtarët mbi incidentet e raportuara të dhunës.
- Konsideroni ndryshime në aktet nënligjore të degëve të grave për të përfshirë klauzola të mbrojtjes së anëtarëve të tyre nga dhuna.
- Promovoni në mënyrë aktive solidaritetin e grave dhe mbështetjen e grave viktimat të dhunës. Mbështetni publikisht viktimat dhe flisni në lidhje me format e ndryshme të dhunës me të cilat përballen gratë në politikë.
- Konsideroni një koalicion ndërpartiak midis të gjitha degëve të grave të partisë politike për nënshkrimin e një deklaratë etike dhe aktivitete të përbashkëta për të dënuar dhunën ndaj grave në politikë.
- Konsideroni një fushatë të vazhdueshme shumë partiakë për rritjen e ndërgjegjësimit të DhKG në politikë.
- Përmbajuni punës së përbashkët dhe promovimit të solidaritetit ndërpartiak të grave, me shfaqjen e shembujve pozitivë të bashkëpunimit dhe besimit.
- Përdorni Klubin e deputeteve si një forum për diskutim dhe vendosjen e rregullave për bashkëpunim dhe solidaritet në drejtim të mbrojtjes së grave në politikë, me mjete ligjore ose të tjera.
- Organizoni aktivitete dhe fushata arsimore brenda anëtarëve për të njohur dhe luftuar në mënyrë adekuate format e ndryshme të dhunës.

Rekomandime për institucionet shtetërore

- Pranoni ekzistencën e formave specifike të dhunës, që godasin gratë politike.
- Siguroni mbrojtje të viktimave të dhunës së bazuar politikisht brenda administratës shtetërore dhe në vend.

- Siguroni edukim dhe trajnim për administratën shtetërore për të njohur dhe trajtuar në mënyrë të efektshme rastet e dhunës politike, veçanërisht ndaj grave aktive politikisht.
- Konsideroni krijimin e mekanizmave dhe rregulloreve për mbrojtjen e grave politikane.
- Konsideroni krijimin e ligjeve ose procedurave për përfaqësim më të mirë të grave në pozitat udhëheqëse brenda administratës shtetërore.
- Konsideroni krijimin e një organi të specializuar, shumë institucional për trajtimin e rasteve dhe incidenteve të dhunës dhe sigurimin e ndihmës ndaj viktimave të dhunës politike.
- Siguroni buxhet për programe dhe strehimore në nivelet lokale dhe rajonale për viktimat e dhunës së bazuar politikisht, veçanërisht grave.
- Konsideroni sanksione kundër autorëve të dhunës politike.
- Sensibilizoni gjyqësorin, autoritetet lokale dhe rajonale dhe departamentet e ministrive dhe inspektorateve për trajtimin e rasteve të dhunës politike dhe atë në bazë gjinore në format dhe manifestimet e saja të shumta [në vendin e punës, në zgjedhje, në jetën private].

Rekomandime për mediat

- Pranoni rolin e tyre kyç në publikimin e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave politikisht aktive, parandalimin dhe ekspozimin.
- Pranoni përgjegjësinë dhe rolin e tyre në ekspozimin e stereotipave dhe gjuhës seksiste.
- Kultivoni imazhin pozitiv të grave politikane, abstenoni nga përdorimi i gjuhës seksiste dhe stereotipave kur raportoni për aktivitetet politike të grave ose të rasteve të ngacmimit dhe dhunës.
- Siguroni aktivitete të veçanta edukative për gazetarët të cilët mbulojnë politikën ose zgjedhjet për t'i përgatitur ata për të raportuar dhe mbuluar incidente ose kërcënime të dhunës ndaj grave politikane.
- Fokusoni vëmendjen e mediave në tregime pozitive, për të mos dhënë mundësi kryerësve të dhunës të përdorin mediat për të goditur gratë politikisht aktive.
- Angazhohuni në një fushatë të vazhdueshme mediatike kundër stereotipave, seksizmit dhe dhunës ndaj grave politikane.

Rekomandime për shoqërinë civile

- Përqendroni vëmendjen në ngritjen e vetëdijes për praninë dhe ndikimin e dhunës ndaj grave politikisht aktive për shoqërinë në tërësi.
- Organizoni veprime të shumë palëve të interesit dhe aktivitete të vazhdueshme të fushatës në të gjithë vendin.
- Organizoni aktivitete dhe fushata arsimore me shumë palë të interesit për të ngritur zërin kundër dhunës në politikë, veçanërisht ndaj grave.
- Sigurimi i ndihmës dhe mbështetjes enkas për gratë viktime të dhunës politike.
- Organizoni diskutime në forume publike në çdo komunë dhe nivel rajonal për shkëmbimin e mendimeve dhe përvojës se si t'i kundërviheni në mënyrë efektive formave të ndryshme të dhunës, stereotipave, gjuhës seksiste, inflamatore dhe të urrejtjes ndaj grave në politikë.

- Kontrolloni dhe rregullisht botoni punën e ekspertëve për temat, llojet dhe nëntipet e dhunës ndaj grave në politikë, dhe studimet për zgjidhjen e rasteve.
- Hulumtoni marrëdhëniet midis stereotipave kulturorë, mentalitetit dhe dhunës ndaj grave politikisht aktive.
- Trajtoni dhe punoni me mediat për njohjen dhe raportimin e dhunës ndaj grave në politikë.
- Ofroni shërbime ligjore pro-bono (pa pagesë) për gratë politikane viktime të dhunës ose nën kërcënim të dhunës.
- Siguroni aktivitete për aftësi që ju mundëson grave jo politike të marrin role proaktive në partitë politike, duke përmirësuar përfaqësimin politik në vend.
- Dizajnoni aktivitete dhe fushata për të ndihmuar shoqërinë që krejtësisht të ndalojë tolerancën e dhunës, veçanërisht ndaj grave.
- Angazhoni si gratë ashtu edhe burrat në aktivitete të ndryshme dhe seanca trajnimi për tu njohur me të gjitha llojet e dhunës së mbështetur politikisht dhe për të arritur së bashku me zgjidhjet e duhura.
- Organizoni aktivitete për shkëmbimin e përvojës dhe njohurive teknike nga gratë politikane me partitë simotra dhe institucionet e BE-së, organizoni debate dhe forume ndërkombëtare.

